



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



RAPORTI VJETOR I
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
VITI 2012

Tiranë më 15 Shkurt 2013

PËRMBAJTJA

Fjala përshëndetëse e Komisionerit

KAPITULLI I - VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

1.1 Hyrje

1.2 Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit për Vitin 2012 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

KAPITULLI II – SITUATA AKTUALE E DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI

2.1. Kuadri ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri

2.2. Situata e diskriminimit në Shqipëri

2.2.1. Diskriminimi për shkak të racës dhe etnisë

2.2.2. Diskriminimi për shkak të gjinisë

2.2.3. Diskriminim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor

2.2.4. Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar

KAPITULLI III - TRAJTIMI I ANKESAVE

3.1. Procedura e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për rastet e diskriminimit

3.2. Procedura e ankesave

3.3. Numri i ankesave

3.4. Ankuesit

3.5. Ankesat sipas shkaqeve të diskriminimit

- Ankesa për diskriminim për shkak të races
- Ankesa për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar
- Ankesa për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike
- Ankesa për diskriminim për shkak të orientimit seksual
- Ankesa për diskriminim për shkak të gjinisë
- Ankesa për diskriminim për shkak të gjendjes shoqerore dhe perkatesise prinderore
- Ankesa për diskriminim për shkak të moshës
- Ankesa për diskriminim për shkak të bindjeve politike
- Ankesa për diskriminim për shkak të etnisë
- Ankesa për diskriminim për shkak të vendbanimit
- Ankesa për diskriminim për shkak të cilësive të veçanta
- Ankesa për diskriminim pa shkak të cilësuar

3.6 Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat

- Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve
- Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

- Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit
- 3.7 Subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa
 - 3.8 Shpërndarja rajonale e ankesave
 - 3.9. Ankesa të cilat nuk janë pranuar për shkak të kompetencave
 - 3.10. Rezultatet e procedimeve dhe vendimeve të ankesave

KAPITULLI IV – NDËRGJËGJESIMI

- 4.1 Kontakte të drejtpërdrejta me komunitetin
- 4.2. Hartimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese si broshura, fletëpalosje dhe postera
- 4.3 Organizimi i Konferencave dhe Trajnimeve nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në bashkëpunim me OJF-të
- 4.4 Pjesëmarrja në tryeza diskutimi
- 4.5 Pjesëmarrje të Komisionerit në Konferenca dhe Seminare
- 4.6 Leksione të hapura me studentë
- 4.7 Roli i medias

KAPITULLI V – REKOMANDIME DHE RAPORTIME TË KOMISIONERIT

- 5.1 Rekomandime dhe mendime ligjore
- 5.2 Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

KAPITULLI VI - NGRITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KOMISIONERIT

- 6.1 Seminare, Konferenca dhe Trajnime

KAPITULLI VII–BASHKËPUNIMI ME AKTORËT E TJERË

- 7.1 Bashkëpunimin Institucional
- 7.2 Bashkëpunimi me organizatat jo-fitimprurëse
- 7.3 Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare

KAPITULLI VIII – ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

- 8.1 Menaxhimi i burimeve njerëzore
- 8.2 Menaxhimi i burimeve financiare

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Fjala përshëndetëse e Komisionerit

**E nderuar Znj. Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar Deputetë,**

Me ndjenjën e një përgjegjësi të madhe që mbart Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi si një institucion që siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe sjelljet që e nxisin atë, po paraqes pranë Kuvendit të Shqipërisë Raportin Vjetor 2012.

Aktiviteti i Komisionerit është zhvilluar në funksion të realizimit të proceseve intensive demokratizuese dhe integruese ku Shqipëria është përfshirë dhe ushtrimit të kompetencave që ligji i ka përcaktuar.

Ky raport është konceptuar duke mbajtur parasysh detyrimin ligjor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të parashikuar në nenin 26 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ku thuhet shprehimisht se *“Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e komisionerit dhe të zyrës”*.

Përmbajtja e këtij raporti është ndërtuar bazuar në misionin dhe objektivat e Zyrës së Komisionerit të reflektuara në dokumentin e miratuar nga institucioni “Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit për Vitin 2012 i Komisionerit Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi”, si dhe në rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë ka adresuar për vitin 2012.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERE

Irma BARAKU

KAPITULLI I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

1.1 Hyrje

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2012, ka ushtruar funksionet dhe kompetencat e tij në përputhje me Planin Strategjik 2012-2015 dhe Planin i Veprimit për vitin 2012. Ky është dokumenti bazë mbi të cilin mbështetet veprimtaria e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Planin Strategjik synon të kthehet në një instrument për KMD-në dhe për të gjithë aktorët e tjerë publikë dhe jopublikë, për një kuptim të përbashkët të situatës së mosdiskriminimit, sfidave që shtrihen përpara dhe përballimin e tyre. Kjo strategji parashtron edhe bashkëpunimin dhe bashkërendimin mes të gjithë aktorëve, rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse, për të arritur në një qasje efikase dhe të harmonizuar në luftën për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjithashtu, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, Komisioneri ka patur në vëmendje edhe objektivat e parashtruara në Rezolutën e datës 12 Korrik 2012 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “*Për vlerësimin e punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2011*”.

Kështu, në kuadër tëndjekjes së vazhdueshme të objektivave strategjike, sipas planit të veprimit dhe kontrollin e rreptë të zbatimit të tyre, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shtator 2012 ka hartuar raportin 6 mujor të monitorimit të Planit të Veprimit për vitin 2012 të Planit Strategjik 2012-2015 ku janë evidentuar njëkohësisht hapat për adresimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të tij dhe nevojat për ndryshim dhe rivlerësim të aktiviteteve të parashikuara. Ndërkohë, Zyra e Komisionerit ka përgatitur raportin e monitorimit 1 vjeçar për zbatimin e Planit Strategjik 2012-2015 dhe Planit të Veprimit për vitin 2012 të KMD-së si dhe po harton Planin e Veprimit për vitin 2013.

Në kuadër të rritjes së numrit të shqyrtimit të ankesave me objekte të ndryshme të çështjeve të pabarazisë, duke i dhënë përparësi trajtimit kryesisht të tyre, në total numri i ankesave të shqyrtuara nga Zyra e komisionerit është 6-fishuar. Për më tepër, Komisioneri ka përmbushur të gjitha kompetencat ligjore, duke konsideruar institucionin jo vetëm këshillues por edhe ndëshkues. Në këtë kontekst, KMD ka dhënë 5 vendime ku ka konstatuar diskriminim të shoqëruara me sanksione me gjobë. KMD ka dërguar 8 Rekomandime për përmirësimin e situatës së diskriminimit për grupet vulnerabël. Bashkëpunimi me gjyqësorin ka rezultuar në kërkesat për parashtrimin nga ana e KMD-së të 2 mendimeve me shkrim në lidhje me kërkesë-paditë me objekt diskriminimin si dhe asistencë për përgatitjen e dokumentacionit

për parashtrimin e kërkesë-padisë në gjykatë. Vlen të theksohet se ka patur një shtrirje gjeografike të numrit të ankesave të paraqitura në KMD.

Zyra e Komisionerit ka identifikuar nevojat për amendime ligjore dhe përmirësim të mëtejshëm të mekanizmave ligjorë, duke dërguar, gjatë vitit 2012,4 Rekomandime Legjislative për ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues në fushën e diskriminimit.

Një vëmendje të veçantë Komisioneri i ka kushtuar edhe rolit të medias, duke u shfaqur më shumë në median e shkruar dhe vizive, me qëllim nxitjen e qytetarëve për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre, krijimin e besimit të publikut tek institucioni, rritjen e ndërgjegjësimit në nivel lokal dhe në sektorin privat. Së fundmi, KMD ka përgatitur dhe po shfaq në dy televizione të rëndësishme kombëtare një spot televiziv, ndërgjegjesues mbi diskriminimin.

Vendosja e bashkëpunimit me aktorë të tjerë vlerësohet nga ana e institucionit si një lehtësi në ushtrimin e aktivitetit të tij. Disa marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar me institucione shtetërore, shoqëri në civile dhe organizatat ndërkombëtare, janë zhvilluar disa aktivitete të përbashkëta etj.

1.2 Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit për Vitin 2012 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Me qëllim përmbushjen e kompetencave të parashikuara në Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ushtron aktivitetin në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ushtron veprimtarinë në përputhje me prioritetet e përcaktuara në “*Planin Strategjik 2012-2015 dhe Planin e Veprimit për vitin 2012 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Me datë 23 prill 2012 u prezantua ***Plani Strategjik 2012-2015 dhe Plani i Veprimit për vitin 2012 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi***’.

Në këtë dokument janë përcaktuar vizioni, qëllimet dhe objektivat konkrete të veprimtarisë së ardhshme të institucionit.

Në kuadër të qëllimit të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, vizioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitet e ardhshme është: ***“Të jetojmë në një shoqëri ku respektohet parimi i barazisë dhe promovohet barazia e shanseve dhe e mundësive”*** .

Në realizim të këtij vizioni, misioni i Komisionerit për vitet e ardhshme është ***mbrojtja nga diskriminimi i të gjithë personave të parashikuar nga ligji*** përmes:

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

- ofrimit të ndihmës së pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim;
- rritjes së ndërgjegjësimit nëpërmjet informimit për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi, për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje dhe zhvillimit të dialogut të rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë dhe organizatat joqeveritare;
- kryerjes së sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin si edhe
- publikimit të raporteve dhe dhënies së rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Konkretisht, prioritetet strategjik kryesore të KMD-së, për t'u realizuar deri në vitin 2015, janë: **a) - Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për rolin e KMD-së në këtë fushë**(duke përfshirë arritjen e një niveli bazë ndërgjegjësimit të publikut në përgjithësi; arritjen e një niveli të lartë ndërgjegjësimit në institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare, në mënyrë specifike të drejtuesve të institucioneve arsimore, mësuesve, psikologëve, nxënësve dhe studentëve; arritjen e një niveli të lartë ndërgjegjësimit në fushën e punësimit në sektorin publik dhe privat, në mënyrë specifike të Departamentit të Administratës Publike, të Inspektorateve të Punës, Sindikatave, Dhoma e Tregtisë; arritjen e një niveli bazë ndërgjegjësimit në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve për nëpunësit civilë dhe punonjësit e njëjësive të qeverisjes vendore; si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të medias për të raportuar çështje të diskriminimit); **b) - Rritja e numrit të ankesave drejtuar KMD-së**, për personat me aftësi të kufizuara në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve si dhe në fushën e arsimimit, si dhe për komunitetin Rom dhe komunitetin Egjiptian në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve si dhe në fushën e punësimit; zgjerimi i aktivitetit të KMD-së me qëllim sigurimin e mbrojtjes nga diskriminimi dhe ofrimin e një shërbimi sa më pranë qytetarëve dhe grupeve më të cenueshme si dhe krijimi i një mekanizmi efektiv për bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile; **c) - Organizimi i përshtatshëm institucional me qëllim rritjen e efikasitetit të Zyrës së KMD-së** (që përfshin ristrukturimin e institucionit me qëllim ndarjen sa më të qartë të kompetencave; përqendrimin e shqyrtimit të ankesës brenda një strukture të vetme të Zyrës së KMD-së; fuqizimin e kapaciteteve të strukturës së marrëdhënieve me publikun; fuqizimi i kapaciteteve profesionale të stafit të KMD-së) **d) - Konsolidimi i rolit të KMD-së në sektorin publik dhe privat**(që përfshin konsolidimin e rolit të KMD-së në sektorin publik; konsolidimin e rolit të KMD-së në opinionin publik; Rritjen e vizibilitetit të KMD-së nëpërmjet pjesëmarrjes në median e shkruar dhe atë vizive; krijimin e standardeve të larta profesionale gjatë ushtrimit të kompetencave).

Në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të Planit të Veprimit për vitin 2012 të Planit Strategjik 2012-2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shtator 2012 është hartuar raporti 6 mujor i monitorimit të strategjisë dhe janë evidentuar njëkohësisht hapat për adresimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të tij dhe nevojat për ndryshim dhe rivlerësim të aktiviteteve të parashikuara. Ndërkohë, aktualisht Zyra e Komisionerit po përgatit raportin e monitorimit një-vjecar për Zbatimin e Strategjisë 2012-2015 dhe Planit të Veprimit për vitin 2012 të KMD-së si dhe ka përgatitur Planin e Veprimit për vitin 2013.

KAPITULLI II

SITUATA AKTUALE E DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI

2.1. Kuadri ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri

Në vitet e fundit, Shqipëria ka krijuar një kuadër ligjor të gjerë dhe solid në fushën e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Parashikimet në këtë fushë gjenden një sërë aktesh, duke filluar me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për të vijuar më pas me ligje të tjera. Më poshtë paraqiten në mënyrë sintetike parashikimet e legjislacionit aktual shqiptar në këtë fushë:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, parashikon në nenin 18 se “*të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*”. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Proceduarave Administrative*” është një tjetër akt mbi bazën e të cilit vepron KMD-ja gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Në këtë ligj parimi i barazisë sanksionohet si një nga parimet bazë i cili duhet të udhëheqë veprimtarinë e administratës publike. Ligji nr 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, i cili në nenin 9, “*Ndalimi i diskriminimit*”, parashikon ndalimin e çdo lloj diskriminimi në fushën e punësimit, por për një numër më të kufizuar shkaqesh se Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Gjithashtu, kuadri ligjor në fushën e barazisë dhe mos-diskriminimit, për shkaqe të veçanta parashikohet edhe në ligjet e tjera si: Ligji nr.9970, datë 24.07.2008, “*Për barazinë gjinore në shoqëri*” i cili parashikon ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë në nenin 6 të tij, Ligji nr. 10347, datë 04.11.2010, “*Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*” i cili eliminon të gjitha format e diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës; Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*” etj.

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, është ligji organik mbi bazën e të cilit sigurohet mbrojtja nga diskriminimi si dhe ligji në kuadër të të cilit është krijuar edhe institucioni i KMD-së, si person juridik publik, i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij dhe si autoriteti përgjegjës i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin. Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë joshteruese shkaqesh. KMD-ja ka kompetenca për të pranuar ankesa jo vetëm ndaj sektorit publik, por edhe ndaj subjekteve privatë dhe individëve. Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore janë të parashikuara në tre krerë më vete dhe përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, në fushën e arsimit, si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe

mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Në zbatim të legjislacionit janë hartuar dhe dokumenta strategjik dhepolitika mos-diskriminimi, ku përmendim: Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013; Plani i Veprimit për Fëmijët 2012 – 2015; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje, 2011-2015; Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007- 2013; Plani Kombëtar i veprimit për Dekadën e përfshirjes Rome 2012-2015.

2.2. Situata e diskriminimit në Shqipëri

Në mënyrë që të garantohet sa më mirë mbrojtja nga diskriminimi, kemi nevojë që të dimë situatën e diskriminimit dhe efektet e implementimit të instrumenteve ligjorë në vend. Nga një analizë e kujdesshme e të dhënave që disponojmë është evidentuar se në Shqipëri, nuk ka një sistem unik dhe të standardizuar të regjistrimit, mbledhjes dhe analizimit të të dhënave mbi diskriminimin. Rrjedhimisht, është e vështirë të bëhet një pasqyrim objektiv i mbrojtjes së parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, gjithashtu është e vështirë që të përcaktosh llojet dhe shkaqet. Ky kapitull paraqet situatën e diskriminimit në Shqipëri duke u fokusuar në llojet më të përhapura të diskriminimit. Ky këndvështrim është bazuar në burime të ndryshme të disponueshme. Gjithsesi përpara paraqitjes së të dhënave që tregojnë situatën e diskriminimit, është e nevojshme që të jepen disa vëzhgime të përgjithshme bazuar në burimet dhe eksperiencën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga praktika e Komisionerit është vënë re se, qytetarët nuk janë të mirë-informuar mbi diskriminimin, madje shpeshherë ata e identifikojnë diskriminimin me forma të tjera të sjelljeve të paligjshme apo të parregullta. Si shembull, është vënë re se ankuesit plotësojnë ankesa për pretendim diskriminimi, të cilat në thelb kishin të bënin me shkeljen e një të drejte, por nuk çënonin parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Për këtë arsye, në Planin Strategjik 2012-2015 dhe Planin e Veprimit për vitin 2012 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është përcaktuar si një ndër prioritetet strategjik kryesore të KMD-së, për t'u realizuar deri në vitin 2015, ndërgjegjësimi i popullsisë mbi çështjet e diskriminimit, në mënyrë që qytetarët të arrijnë të bëjnë dallimin mes diskriminimit dhe veprimeve të tjera të paligjshme.

Në vijim të prioritetëve strategjike të përcaktuar në këtë dokument, pas një analize të situatës së diskriminimit, Komisioneri ka evidentuar disa grupe si më vulnerabël dhe më të cënueshëm për shkak të karakteristikave të tyre specifike, të cilat i bëjnë ata viktimat të diskriminimit. Megjithatë, orientimi i veprimtarisë së KMD-së në fusha apo drejt grupeve të caktuara ku diskriminimi shfaqet më shpesh dhe në shumë dimensione, nuk shmang nevojën për vëmendje edhe ndaj çdo rasti individual dhe çdo shkak të veçantë diskriminimi, pavarësisht përkatësisë ose jo të personit të diskriminuar në një ose më shumë nga grupet e gjithëpranuara si më të cënueshme.

Nëse hedhim një vështrim në grupet më vulnerabël si romët, LGBT, personat me aftësi të kufizuara, gratë dhe fëmijëve, dalim në përfundim se programet dhe aktivitetet për fuqizimin dhe integrimin e tyre kryesisht u drejtohen drejtpërdrejtë vetëm anëtarëve të këtyre grupeve dhe praktika të tilla rrisin mundësinë që ata të mos kuptojnë se të gjitha shkaqet e diskriminimit gëzojnë mbrojtje të barabartë.

Shpesh individët mund të jenë viktimë të shumëfishta për shkak të përkatesisë në më shumë se një grup të riskuar. Kështu, në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje, 2011-2015, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj, vihet re një qasje shumë pozitive, duke trajtuar dhe ndërgjegjësuar për diskriminimin potencial të shumëfishtë me të cilin mund të përballen kategori më tepër të cënueshme grash, siç janë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, gratë rome apo gratë nga zonat rurale në krahasim me ato të zonave urbane.

Është e nevojshme që të ketë një bashkëveprim të të gjithë aktorëve kyç për të arritur një nivel të lartë të mbrojtjes nga diskriminimi. Kjo mund të arrihet nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta dhe të koordinuara të të gjithë institucioneve dhe shoqërisë civile, duke përfshirë institucionet e arsimit dhe median si aktorë kyç.

Gjithashtu, duhet që të implementohen në mënyrë më efikente masat e parashikuara në dokumente të ndryshëm strategjik, si dhe të monitorohet zbatimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme, madje kur është e nevojshme të hartohen masa të tjera të veçanta.

Për të krijuar një pasqyrë sa më të qartë mbi situatën e diskriminimit kemi ndërtuar këtë pjesë të raportit duke pasur si kriter shkakun për të cilin një subjekt mund të bëhet viktimë e sjelljeve diskriminuese, mbështetur në parashikimet ligjore të shkaqeve të diskriminimit.

2.2.1. Diskriminimi për shkak të racës dhe etnisë

Mund të thuhet se Shqipëria ka një kuadër ligjor të avancuar për mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të racës dhe etnisë. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton parimin e mosdiskriminimit në nenin 18/2, duke parashikuar shprehimisht se *“askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si raca, (...) etnia (...)”*. Gjithashtu, ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* parashikon se mbrojtja e këtyre grupeve hyn në objektin e këtij ligji, por kërkohet njëkohësisht që institucionet përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencës të marrin masa me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin. Kështu, neni 18 i këtij Ligji ngarkon Këshillin e Ministrave dhe Ministrin e Arsimit dhe të Shkencës që të marrin masa me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim të pakicave si dhe të garantojë respektimin e të drejtës për arsim në gjuhën e pakicave.

Sipas Censurit të vitit 2011, të realizuar nga INSTAT rezulton se numri i përgjithshëm i popullsisë në Republikën e Shqipërisë është 2,800,138 banorë. Sipas të dhënave të Censurit 2011 rezultojnë këto të dhëna për minoritetet sipas përkatësisë etnike dhe kulturore: rom 8,301 banorë ose 0.30 %; grek 24,243 banorë ose 0.87 %; maqedonase 5,512 banorë ose 0.20

%; malazeze 366 banorë ose 0.01 %; arumune 8,266 banorë ose 0.30 % ; egjiptiane 3,368 banorë ose 0.12 %; Ndërkohë rezulton se 390,938 banorë ose 13.96% kanë preferuar të mos përgjigjen dhe përgjigjet e 44.144 banorëve ose 1.58% kanë qënë të pavlefshme/ e përcaktuar.

Komuniteti Rom vazhdon të jetë ndër grupet më të marginalizuara dhe të diskriminuara. Duke njohur situatën e vështirë të komunitetit rom, Qeveria ka miratuar një plan veprimi kombëtar në kuadër të Dekadës së Përfshirjes Rome, që synon përmirësimin e jetesës së këtij komuniteti, integrimin e tyre, por njëkohësisht duke ruajtur identitetin e tyre.

Megjithatë, zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Romëve, Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Romëve dhe përfundimet operationale të seminarit të dhjetorit të 2011-ës mbi përfshirjen e komuniteteve romë dhe egjiptiane në kuadrin e integritit të Shqipërisë në BE është një proces që duhet të njohë një hap cilësor, sepse në këndvështrimin e institucioneve evropiane vazhdon të jetë shumë i ngadaltë për shkak të burimeve të papërshtatshme dhe koordinimit të pamjaftueshëm të institucioneve të përfshira në nivel qendror. Janë krijuar grupe pune për romët në 10 qarqe për të monitoruar, vlerësuar dhe bërë plane për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve. Gjithsesi, njësitë e qeverisjes vendore nuk janë ende mjaftueshëm të përfshirë dhe të ndërgjegjësuar duke lënë një numër të madh shërbimesh kritike për romët që ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile dhe të financuara nga donatorët ndërkombëtarë, çka mund të verë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e tyre afatmesme¹.

Edhe nga vëzhgimet që ka marrë Komisioneri nga “Ditët e Hapura” të zhvilluara në qytete të ndryshme të Shqipërisë,” në kuadër të projektit të OSBE-ODIHR “Praktikat më të mira për Integritin e Romëve”, rezulton se problematikat kryesore që komuniteti Rom ndesh dhe reflektoi si ankesa për pretendim diskriminimi pranë punonjësve të KMD-së, janë: strehimi, gjuha e urrejtjes, regjistrimi i popullsisë romë, etj².

Një aspekt pozitiv që është vënë re gjatë “Ditëve të Hapura” të zhvilluara nga Komisioneri, është bashkëpunimi i mirë që ky komunitet ka me strukturat e Drejtorisë Arsimore dhe Strukturën e Shërbimit Social pranë Bashkive përkatëse.

Romët ende përballen me kushte shumë të vështira jetese dhe diskriminim të shpeshtë. Problematikat kryesore me të cilat ndeshet komuniteti rom kanë të bëjnë kryesisht me: a) punësimin b) arsimin c) strehimin d) kujdesi shëndetësor.

a) Punësimi

Në vitin 2012, në krahasim me vitet 2010 dhe 2011, numri i punëkërkuësve të papunë nga ky komunitet është rritur përkatësisht me 10% dhe 20%, shifër që tregon ndërgjegjësimin e tyre

¹Progres Raporti 2012 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin European dhe Këshillin

² Shih Kapitullin II –Trajtimi i Ankesave

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

për t'u paraqitur pranë zyrave të punësimit dhe për të përfituar nga shërbimet e ndryshme, që ofrohen veçanërisht për grupet e veçanta, ku bën pjesë edhe Komuniteti Rom³.

Megjithatë hapa pozitiv janë ndërmarrë gjatë vitit 2012, në lidhje me punësimin dhe formimin profesional. Konkretisht, janë zbatuar 2 programe që kanë prioritet punësimin e punëkërkuesve të papunë nga grupet e veçanta:

- Në zbatim të VKM nr. 48, datë 16.01.2008 "*Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, në vështirësi*". Punëkërkues të papunë në vështirësi sipas këtij programi konsiderohen të papunët afatgjatë, personat, që përfitojnë ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe personat nga **komuniteti rom** etj. Gjatë vitit 2012 janë përfshirë në këtë program 337 punëkërkues të papunë nga grupet e veçanta, ku janë të përfshirë edhe antarë të komunitetit rom.
- Në zbatim të VKM nr. 27, datë 11.01.2012, "*Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta*". Me anë të këtij programi synohet mbështetja e punëdhënësve që marrin në punëkërkues të papunë femra nga grupet e veçanta. Femra nga grupet e veçanta janë: femra të trafikuar; femra mbi 50 vjeç; **femra romë**; femra me aftësi të kufizuara; vajza nëna; femra të divorcuara me probleme sociale etj. Gjatë vitit 2012 janë përfshirë në këtë program 36 punëkërkuese të papuna femra nga grupet e veçanta, **ku përfshihen edhe femrat nga komuniteti Rom**⁴.

Megjithë hapat pozitiv, shohim se është e pamundur që të vlerësohet efekti që këto 2 programe kanë patur konkretisht për antaret e komunitetit rom pasi të dhenat nxirren për te gjitha grupet e veçanta që trajtojnë këto programe.

Punëkërkuesit e papunë nga komuniteti rom të regjistruar pranë Zyrave të Punësimit, janë pothuajse të gjithë me arsim 9 -vjeçar dhe i përkasin të gjitha grupmoshave, gjë që tregon se shkak i papunësisë së tyre është i lidhur ngushtë dhe me mungesën e arsimimit.

b) *Arsimi*

Për garantimin e të drejtës për arsim dhe përfshirjen e fëmijëve rom dhe egjiptan në arsim, janë parashikuar masa në kuadër të disa dokumenteve strategjike, siç janë: Plan i Veprimit për Fëmijët 2012-2015, Programi Kombëtar për Braktisjen Zero dhe të Planit të Veprimit për Dekadën e Romëve.

Në drejtim të mbrojtjes nga dhuna dhe shfrytëzimi, problemi i fëmijëve të peregjistruar vazhdon të mbetet një problem që prek më shumë fëmijët rom. Sipas një studimi të UNICEF dhe Qendrës për Studime Ekonomike dhe Sociale "Hartëzimi i fëmijëve rom", nëntor 2011, vlerësohet se janë rreth 359 fëmijë rom të peregjistruar. Sipas të dhënave nga MPÇSSHB, nga data 27.08.2012 e në vazhdim, punonjësit e policisë në bashkëpunim me punonjësit e

³ Të dhëna nga Sekretariati i Romëve, MPÇSSHB

⁴ Të dhëna nga Sekretariati i Romëve, MPÇSSHB

Zyrës Rajonale – Tiranë, kanë identifikuar 30 raste të fëmijëve rom dhe egjiptian, nga mosha 1 muaj deri 14 vjeç, që shfrytëzoheshin nga prindërit në rrugët e Tiranës⁵.

Problemi i mos regjistrimit të fëmijëve rom ndikon edhe në gëzimin në baza të barabarta me të tjerët edhe të shumë të drejtave të tjera, siç janë e drejta për arsim, e drejta për kujdes social e shëndetësor etj. Megjithatë, që prej vitit 2006⁶, Ministria e Arsimit ka marrë masa për regjistrimin e nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikata lindje, duke i ngarkuar Drejtorive të Shkollave detyrimin për të luajtur një rol aktiv në identifikimin e nxënësve Rom dhe marrjen e masave për pranimin e tyre në shkolla, duke lehtësuar këtë proces.

Treguesi zyrtar i braktisjes shkollore vlerësohet të jetë 0.43 % ndërkohë që fenomeni i braktisjes së shkollave është më i përhapur tek fëmijët romë.⁷ Këto të dhëna tregojnë se mbetet akoma për të bërë në këtë drejtim dhe se duhet të vazhdohet me marrjen dhe zbatimin efektiv të masave me karakter pozitiv për të përshpejtuar në këtë mënyrë vendosjen e parimit të barazisë. Gjithashtu, rezultoni se 66 % e nxënësve që ndjekin klasat e “Shansit të dytë” janë rom.⁸ Kjo mund të lexohet edhe si një shifër e ndërgjegjësimit të bërë ndaj komunitetit dhe prindërve romë dhe zbatimit në mënyrë efektive të masave të marra.

Për të garantuar një gjithëpërfshirje në arsim gjatë vitit 2011-2012⁹ janë shpërndarë tekste falas për fëmijët rom që ndjekin arsimin e detyruar, duke ndikuar në këtë mënyrë në eliminimin e një prej barrierave për arsimimin e tyre.

Ka patur raportime të rëndësishme për diskriminim social kundër pjesëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Disa shkolla kanë kundërshtuar që të pranojnë nxënës që u përkasin këtyre komuniteteve, veçanërisht kur ata ishin të varfër. Edhe pse mund të ketë patur raste të refuzimit të shërbimit, ato kanë qënë të rralla dhe diskriminimi kryesisht shprehet nëpërmjet sjelljeve vulgare dhe fyerjeve verbale¹⁰. Një problematikë që duhet ti kushtohet vëmendje është grumbullimi i fëmijëve Rom në klasa të veçanta. OJF-të lokale kanë raportuar se shumë shkolla që kanë pranuar nxënës Rom i veçojnë në klasa të veçanta, duke i mbajtur fizikisht larg të tjerëve.¹¹

Gjithashtu, edhe nga praktika e Komisionerit ka rezultuar një rast, ku fëmijët Rom janë grupuar në një klasë të vetme duke i veçuar nga pjesa tjetër e fëmijëve. Me fillimin e procedurave të hetimit nga ana e Zyrës së Komisionerit, strukturat përgjegjëse kanë reaguar

⁵Faqe zyrtare e MPCSSH: www.mpcs.gov.al

⁶Udhëzim i Ministrisë të Arsimit Nr. 06, datë 9.03.2006 “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje”.

⁷Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” 2012

⁸Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” 2012

⁹Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” 2012

¹⁰Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” 2012

¹¹ 2011 Human Rights Report - Albania (May 24, 2012), Ambasada Amerikane

duke shpërndarë klasën ku ishin grumbulluar nxënësit rom. Gjithashtu, Komisioneri ka realizuar një monitorim lidhur me këtë problematikë.

c) *Strehimi*

E drejta e individit për strehimëshhtë shprehur në formën e një objektivi social për t'u përmbushur, parashikuar në nenin 59, kreu V, të Kushtetutës së Shqipërisë: a. "... shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe me mjetet që disponon synon punësimin në kushte të përshatshme të të gjithë personave të aftë për punë..."; b...plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim. etj,".

Ekziston tashmë legjislacioni, i cili rregullon çështjet e strehimit, si: Ligji nr. 9232 datë 13.05.2004, "*Për programet sociale për strehimin e zonave urbane*"; V.K.M. nr. 814, datë 03.12.2004, "*Për caktimin e normave të strehimit*", si dhe vendimi "*Për dokumentat dhe procedurat që duhet të ndjekin përfituesit nga ky ligj*".

Natyrisht që kjo bazë ligjore synon që të mbrojë shtetas në nevojë, por gjithashtu vendos detyrimin e të interesuarve për të disponuar një nivel të caktuar të ardhurash financiare, me qëllim dhënien e garancisë së nevojshme për shlyerje të kredisë që i akordohet aplikantit për sistemimin me banesë. Kjo mund të konsiderohet si një kriter pengues në drejtim të politikave të strehimit për komunitetin Rom, për shkak të pamundësisë për të realizuar këtë detyrim.

Megjithatë çështja e strehimit paraqitet problematike për një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të komunitetit rom, të cilët jetojnë në kushte të vështira banimi, me hapësira të pamjaftueshme, dhe në ambiente të papërshtatshme.

Është e nevojshme që në këtë situatë qeverisja qendrore dhe lokale duhet të hartojnë plane ndërhyrjeje për të trajtuar dhe siguruar vendbanim alternativ për familjet në kushte të vështira jetese. Ka patur raste ku antaret e komunitetit rom janë dëbuar me force nga vendbanimet e tyre dhe reagimet e autoriteteve pergjegjëse për problemet e strehimit të tyre kanë qene të dobta.

d) *Kujdesi shëndetësor*

Në kuadër të garantimit të së drejtës për kujdes shëndetësor të fëmijëve, vaksinimi i grupeve të marginalizuara, si fëmijët romë, vazhdon të jetë një nga detyrat e punonjësve të kujdesit shëndetësor.¹²

2.2.2. Diskriminimi për shkak të gjinisë

Diskriminimi gjinor është një ndër shkaqet që ka tërhequr vëmendjen e institucioneve shtetërore, por edhe të OJF-ve dhe organizatave ndërkombëtare. Ekziston akoma një hendek

¹² Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve", Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve"

mes kuadrit ligjor dhe nivelit real të barazisë mes meshkujve dhe femrave në aspektin e punësimit, pagës, aksesit në sipërmarrje dhe në kreditë. Gratë vazhdojnë të jenë më pak të përfaqësuara në tregun e punës, në veçanti në vendimmarrjen politike dhe ekonomike¹³.

Ndryshimet që i janë bërë Kodit Zgjedhor me Ligjin nr. 74/2012 datë 19.07.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, synojnë që të përmirësojnë situatën duke garantuar zbatimin real dhe efektiv të kuotës 30% të përfaqësimit të grave në politikë, konkretisht në nenin 38 pika 6 parashikohet se: “Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi” dhe në nenin 102, pika 2 parashikohet se: “Kur ndaj një subjekti zgjedhor është konstatuar shkelja, KQZ-ja zbaton si sanksion plotësues zëvendësimin e çdo vakance në listën e subjektit, në zonën ku është konstatuar shkelja, me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore”

Rezultatet tregojnë se në parlamentin shqiptar u zgjodhën 23 gra në vitin 2009, ndërkohë që në 2005-ën në Kuvend kishte vetëm 10 gra deputete, një rritje nga 7.1 përqind në 16.4 përqind. Vendi që mbanin kandidatet gra në listë influenconte suksesin e tyre.¹⁴ Kjo shifër tregon një progres në rritjen e përfaqësimit të grave në politikë, megjithëse duhen hapa të mëtejshëm për të garantuar barazinë reale midis burrave dhe grave.

Gratë nuk kanë qenë të përjashtuara nga profesioni qoftë nga ligji ose nga praktika, por ato kanë qenë të papërfaqësuara në nivelet më të larta të fushave të tyre. Megjithëse, ligji parashikon pagë të njëjtë për punë të barabartë, qeveria dhe punëdhënësit nuk e kanë zbatuar plotësisht këtë dispozitë¹⁵.

Diferenca gjinore në pagë është një e dhënë e rëndësishme që tregon drejtpërdrejtë se gjinia ndikon në përfitimin e të ardhurave që vijnë prej punësimit. Bazuar në Raportin Kombëtar të Pozicionit të grave dhe Barazisë Gjinore në Shqipëri të vitit 2011, theksohet se në gjithë kategoritë e arsimit gratë marrin paga me të ulëta mujore dhe paga mesatare e grave është 17.63% më e vogël se e burrave në të njëjtin nivel arsimor.

Në një tjetër studim nga një OJF, i cili është bazuar në analizën e 1000 anketimeve të të punësuarve, të mbledhura gjatë periudhës shtator-tetor 2011 në të gjithë zonën urbane të vendit, rezulton se gratë fitojnë më pak se burrat. Rezulton se diferenca gjinore në pagë është së pari rezultat i diskriminimit gjinor. Kjo diferencë për vitin 2011 rezulton të jetë 5,725 leke

¹³Progres Raporti 2012 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin Europian dhe Këshillin

¹⁴Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve “Zgjedhjet Parlamentare, 28 qershor 2009”

¹⁵2011 Human Rights Report - Albania (May 24, 2012), Ambasada Amerikane

ose 17.4 % më pak¹⁶. Pra, vërehet një përqindje e përafërt e diferencës në pagë me bazë gjinore me tendence ngushtimin e saj.

Është bërë pak përparim në zvogëlimin e pabarazive shëndetësore. Në dhjetor të vitit 2011, u lëshua një qarkore nga Ministria e Shëndetësisë për të përfshirë në certifikatat e lindjes, numrin e identifikimit dhe emrin e vajzërisë së nënës për të shmangur deklaratat e gabuara/të rreme në maternitete dhe për të parandaluar mosregjistrimin e fëmijëve, veçanërisht nga komuniteti rom¹⁷.

- *Dhuna ndaj grave*

Bazuar në Konventën e Këshillit të Europës “*Për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*”, e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2012, është përcaktuar se dhuna ndaj grave përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi.¹⁸

Gjatë vitit 2012 janë raportuar mjaft raste të dhunës ndaj grave, të cilat disa herë kanë rezultuar edhe në humbjen e jetës së këtyre grave të dhunuara. Sipas të dhënave¹⁹ të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2012 janë evidentuar 2526 raste të dhunës në familje ose 345 më shumë se vitin e kaluar. Kjo rritje pasqyrohet edhe në rritjen e numrit të kërkesë padive për lëshimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes, ku për vitin 2012 është 1562 ose 217 kërkesë padi më shumë se në vitin 2011.

Vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet trajtimit të viktimave të dhunës pa u diskriminuar dhe duke iu ofruar shërbimet e domosdoshme për rihabilitimin e tyre.

Nga praktika e Zyrës së Komisionerit, është shqyrtuar një rast me iniciativën e Komisionerit, lidhur me dhunën psikologjike ndaj disa grave nga drejtuesi i institucionit ku këto gra trajtoheshin. Lidhur me këtë rast, Komisioneri ka nxjerrë Rekomandim për marrjen e masave me qëllim eliminimin e kësaj situate. Ky rekomandim është zbatuar nga ana e institucioneve, të cilëve i është drejtuar²⁰.

Gjatë vitit 2012 janë marrë hapa pozitiv në drejtim të përmirësimit të legjislacionit penal në këndvështrimin gjinor. Kështu, me ndryshimet që iu bënë Kodit Penal me ligjin nr. 23/12, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar*”, për herë të parë dënohet dhuna në familje si një vepër e veçantë penale. Gjithashtu, janë forcuar veprat penale që kryhen ndaj të miturve. Një risi tjetër e rëndësishme nga pikëpamja e mosdiskriminimit që i është bërë Kodit Penal, është edhe

¹⁶ Studim nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2012 -Pabarazia gjinore në page një rast Shqiptar.

¹⁷ Progres Raporti 2012 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin Europian dhe Këshillin

¹⁸ Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Neni 3.

¹⁹ www.asp.gov.al

²⁰ Shih Kapitullin III

shtojca në nenin 65/a, i cili nuk lejon aplikimin e lirimit para kohe me kusht kur vepra penale është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që për shkaqe të ndryshme nuk mund të mbrohen; është kryer duke përfitur nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës si dhe kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike fetare ose sociale.

Bazuar edhe në Rekomandimet e bëra nga Komiteti CEDAW, pas raportimit të fundit periodik të vitit 2010 të bërë nga shteti shqiptar për ndryshimin e Kodit Penal, në mënyrë që gratë dhe vajzat që prostitutojnë të mos i nënshtrohen ndjekjes penale dhe dënimit penal, Komisioneri me qëllim vendosjen e një praktike barazie dhe mos diskriminim, i rekomandoi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që të rishikohej neni 113 i këtij Kodi (ushtrimi i prostitucionit).

Në lidhje me këtë nen, ligjvënësi miratoi shtimin e një paragrafi, me këtë përmbajtje “*Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet*”, duke rregulluar një diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj grave.

2.2.3. Diskriminim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor

Diskriminimi për shkak të orientimit seksual në Shqipëri është i përhapur si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Problemet me të cilat përballet komuniteti LGBT, janë problemet e të gjithë shoqërisë, ndaj edhe përgjegjësia për të kapërcyer paragjykimet dhe stereotipet, duhet të jetë një shqetësim i gjithë shoqërisë, por edhe shqetësim i organeve të administratës publike, institucioneve arsimore, shëndetësore dhe institucioneve të tjera që kanë një rol kyç në ndërtimin e një shoqërie me tolerante, e cila respekton diversitetin.

OJF-të kanë raportuar disa herë për diskriminim dhe humbje të vendeve të punës për shkak të orientimit seksual. Gjithashtu, janë verifikuar raporte për ngacmime të personave LGBT dhe sjellje brutale nga ana e policëve kundër punonjësve transgjnorë të seksit²¹. Komuniteti LGBT, sidomos personat transgjnorë, vazhdojnë të vuajnë nga diskriminimi dhe të kenë vështirësi për të aksesuar në shërbimet sociale dhe shëndetësore²².

Për të adresuar problematikat me të cilat hasen personat LGBT, nevojitet ndërhyrja në disa aspekte:

Së pari, ekziston nevoja për të rishikuar legjislacionin me qëllim adresimin e masave potencialisht diskriminuese kundrejt personave LGBT. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë*”, ka propozuar të parashikohet, ndër të tjera, edhe orientimi seksual si shkak diskriminimi për të cilin ofrohet mbrojtje në punësim.

²¹2011 Human Rights Report - Albania (May 24, 2012), Ambasada Amerikane

²²Progres Raporti 2012 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin European dhe Këshillin

Së dyti, ndërmarrja e masave konkrete me synim mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT. Zyra e Komisionerit ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e Planit të Masave për mosdiskriminimin për shkak të Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjinator, 2012- 2014, duke dhënë kontributin e tij në propozimet për ndryshimet në kuadrin ligjor dhe për politikat anti-diskriminim në punësim, arsim dhe në fushën e të mira dhe shërbimeve. Disa nga masat e parashikuara në këtë plan, janë: trajnimi i administratës publike në qendër dhe në qeverisjen vendore me konceptet e reja dhe parimet e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi; organizimi i fushatave ndërgjegjëse/sensibilizuese, publikimeve vjetore, botime, fletëpalosje, praktikat suksesshme kundër diskriminimit; marrja e masave konkrete nga institucionet publike dhe bizneset/aktivitetet private për garantimin e barazisë në bazën e ligjit anti-diskriminim; trajnime të specialisteve të zyrave të punësimit dhe të stafëve mësimorë për çështjet LGBT; përfshirja në kurrikulat/ekstra kurrikulat e shkollës të drejtave LGBT si të drejtat e njeriut; rishikimi i teksteve shkollore me përmbajtje diskriminuese; monitorime dhe studime për çështjet e diskriminimit/bulizmit/dhunsqit për fshijn edhe orientimin seksual etj.

Ka patur përpjekje të vazhdueshme nga OJF-të për ndërgjegjësimin e komunitetit LGBT, të cilat janë përgjigjur edhe institucionet shtetërore. Në kuadër të ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, me datë 17 Maj 2012, u realizua për herë të parë në vendin tonë “Festivali i Diversitetit”. Ky komunitet gjeti në këtë organizim mbështetjen e institucioneve si MPCSŠHB-së, KMD-së, organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësitë diplomatike. Gjatë këtij aktiviteti u shpërndanë broshura të ndryshme informuese ndër të cilat dhe broshura “*Si e Mbron Komunitetin LGBT Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi?”*”, e hartuar me kontributin e përbashkët të Ambasadës Pink dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Por duhet thënë se pati dhe reagim kundër siç ishte organizimi i një mitingu nga komuniteti mysliman, apo disa qëndrime fyese dhe denigruese të përdorura ndaj përfaqësuesve të dy OJF-ve që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT.

KMD në çështjet e vitit 2012 ka tërhequr vëmendjen mbi diskriminimin e personave LGBT dhe gjuhën e urrejtjes. Në çështjen e iniciuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është konstatuar gjuhë diskriminuese mbi personat që i përkasin komunitetit LGBT në një deklaratë publike. Masa e përcaktuar në vendimin e Komisionerit ishte detyrimi i personit përgjegjës për diskriminim, për të kërkuar falje publike si dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës e cila prodhon efektin e nxitjes, përhapjes, nxitjen e urrejtjes apo të tjera forma të diskriminimit kundër personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinator të tyre. Vendimi i Komisionerit u mbajt parasysht dhe personi i gjetur përgjegjës për shkeljen, kërkoi falje publike ndaj komunitetit LGBT për deklaratën e tij me gjuhë urrejtje, duke publikuar një artikull në gazetë për këtë qëllim.

Gjithashtu, pjesëmarrja në aktivitetet ndërgjegjëse, hartimi i broshurave, ndjekja me përparësi e çështjeve, dhe deklaratat publike kanë qënë mjetet e përdorura nga KMD për garantimin e të drejtave të komunitetit LGBT.

2.2.4. Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar

Mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara mbetet një çështje që kërkon vëmendje të veçantë. Ekziston një kuadër ligjor që sanksionon këtë të drejtë, por zbatimi i tij mbetet domosdoshmëri dhe ndërgjegjësimi i të gjithë aktorëve për të drejtat e këtij komuniteti.

Kushtetuta dhe Ligjet ndalojnë diskriminimin kundër personave me aftësi të kufizuara fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore në punësim, arsim, shëndetësi dhe shërbime të tjera shtetërore. Megjithatë, punonjësit, shkollat dhe personeli shëndetësor dhe punonjës të shërbimeve të tjera shëndetësore ndonjëherë diskriminojnë këto persona²³.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me personat e cënueshëm nga ana sociale dhe/ose me aftësi të kufizuara, që është pjesë e prioritetit kyç për mosdiskriminimin. Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me vështirësi në aksesin e arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor dhe shërbimet sociale²⁴.

Në Censusin e vitit 2011 u evidentua se një total prej 137 435 personash mbi 15 vjeç u raportuan të kenë patur një lloj të aftësisë së kufizuar. Popullsia 15 vjeç e lart me të paktën një aftësi të kufizuar është 6,2%. Nga këta 62,196 (ose 45,3%) janë meshkuj dhe 75, 239 (ose) 54,7%) janë femra. Po sipas të dhënave të Censurit 2011, rezultojnë këto të dhëna për personat me aftësi të kufizuara sipas kategorisë së aftësisë së kufizuar: 49,996 persona me aftësi të kufizuara në funksionet vizive, 37,919 persona me aftësi të kufizuara në dëgjim, 81,585 persona me aftësi të kufizuara në lëvizje, 40,586 persona me aftësi të kufizuara në kujtesë, 39,402 persona me aftësi të kufizuara të kujdesit ndaj vetes dhe 33,084 persona me aftësi të kufizuara në komunikim.

Megjithëse, në vitet e fundit kuadri ligjor dhe ndjeshmëria e shoqërisë ndaj personave me aftësi të kufizuara është përmirësuar, kjo kategori është në një pozitë më inferiore se pjesa tjetër e shoqërisë. Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë kundrejt personave me aftësi të kufizuara ekziston në të gjitha aspektet e jetës sociale dhe private dhe është më i theksuar në punësim, arsim, aksesin në ndërtesa dhe shërbime si dhe në jetën e pavarur.

Pozita e personave me aftësi të kufizuara mund të vëzhgohet më mirë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë, nivelin e ulët të arsimit, varfërinë, përfaqësimin e ulët në jetën politike, riskun e institucionalizimit, si dhe mungesën e përshtatjes për këtë kategori, e cila sjell vështirësi kryesisht në aksesin në shërbime dhe ndërtesa.

²³ 2011 Human Rights Report - Albania (May 24, 2012), Ambasada Amerikane, Varianti original anglisht.

²⁴ Progres Raporti 2012 për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin European dhe Këshillin

Hapa pozitiv janë ndërmarrë në përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë aspekt, mund të përmendim ratifikimin me datë 15 nëntor 2012 të Konventës së OKB-së, “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (KDKPAK), e cila ka qënë e nënshkruar nga qeveria shqiptare që në vitin 2009. Natyrisht që ratifikimi i kësaj Konvente, si instrumenti themelor ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, ngre në një nivel më të lartë mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Por, nga ana tjetër, ratifikimi i kësaj Konvente kërkon përmirësimin e kuadrit të brendshëm ligjor me qëllim përputhjen me standartet e parashikuara në KDKPAK. Për këtë arsye është në proces hartimi i një ligji integral për personat me aftësi të kufizuara, si një hap i parë drejt këtyre përmirësimeve legjislative.

Gjatë vitit 2012 ka ndodhur ndryshime në dy ligjet që rregullojnë statusin e personave me aftësitë kufizuara në lëvizje dhe në shikim dhe konkretisht në Ligjin 8626 datë 22.06.2000 “Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjit” të ndryshuar dhe Ligjin nr. 8098 datë 23.03.1996 “Për statusin e të verbrit”. Ndryshimet e bëra në këto dy ligje kërkonin nxjerrjen e akteve nenligjore dhe vonesa në nxjerrjen këtyre akteve nënligjore rëndoi ndjeshëm situatën e këtyre personave.

Gjithashtu, një hap tjetër i rëndësishëm në përmirësimin e kuadrit ligjor është edhe ndryshimi në Ligjin nr. 69/2012 dt. 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë ligj rregullohet në mënyrë të posaçme, në Kreun 11, arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në ligj parashikohen parimet mbi bazën e të cilave duhet të bëhet arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe deri tek ndjekja e institucioneve arsimore dhe organizimi i arsimimit të këtyre fëmijëve. Gjithsesi, ngelet shumë punë për t’u zbatuar në mënyrë sa më efektive ky ligj, duke filluar nga përshtatshmëria e ambienteve të institucioneve arsimore, rishikimi i kurrikulave, teksteve dhe procesit mësimor, trajnimi i mësuesve etj.

Situata aktuale, sipas të dhënave të Censurit 2011, tregon se 33 440 persona me aftësi të kufizuara nuk kanë ndjekur asnjëherë shkollën, prej tyre 21,787 janë femra me aftësi të kufizuara. Kjo e dhënë tregon për nevojën emergjente për marrjen e masave për të garantuar gëzimin e të drejtës për arsim nga personat me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të problematikave që hasin personat me aftësi të kufizuara, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë - ANAD, solli në vëmendjen e Komisionerit problemin e dy studentëve me aftësi të kufizuara në dëgjim, të cilët studionin në një universitet, por procesi i mësimdhënies nuk ishte i përshtatur. Për këtë çështje, Komisioneri rekomandoi marrjen e masave për sigurimin e përshtatjes së arsyeshme për të garantuar në këtë mënyrë ushtrimin në mënyrë të barabartë të së drejtës për arsimim të këtyre studentëve me studentet e tjerë. Ofrimi i shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtën e arsimimit për personat me aftësi të kufizuara duhet të jetë efektive dhe të mos mbetet vetëm një parashikim ligjor.

Në fushën e punësimit, konstatohet se problematikat kryesore të personave me aftësi të kufizuara janë mungesa e përshtatjes së arsyeshme, niveli i ulët i njohjes së punëdhënësve

mbi aftësitë dhe kapacitetet që zotërojnë personat me aftësi të kufizuara, si dhe niveli i ulët i vetëbesimit i personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre për potencialet që ata kanë.

Papërshtatshmëria e ndërtesave publike është një problem thelbësor për arritjen e barazisë. Shumica e ndërtesave janë të papërshtatura për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe ndërtesat e institucioneve të administratës publike. Sipas të dhënave të Censurit 2011, rezultojnë se nga 598 267 ndërtesa me qëllim banimi, nga këto vetëm 7 303 ndërtesa janë të pajisura me ashensor. Nga këto 87 737 ndërtesa janë me mbi 2 kate.

Sipas një raport studimi të realizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, për të drejtën zgjedhore të zgjedhësve me aftësi të kufizuara²⁵, rezultojnë se për shkak të mungesës së përshtatshmërisë fizike, por edhe për shkak të mungesës së garantimit të zgjidhjeve alternative, qofshin këto mjete ligjore apo shërbime mbështetëse votuesit me aftësi të kufizuara rezultojnë me më pak akses në procesin zgjedhor. Përgjithësisht qendrat e votimit të vëzhguara kishin hyrje të përshtatur, megjithatë ato nuk ishin plotësisht të aksesueshme pasi mund të ishin vendosur në katet e sipërme dhe jo në katin përdhe të ndërtesës.

Edhe pse vëzhgimi i këtyre ndërtesave ka patur si qëllim realizimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, rezultojnë se ndërtesat e zgjedhura si qendra votimi janë në pjesën më të madhe institucione arsimore, dhe pjesa tjetër institucione shëndetësore dhe ndërtesa publike. Pra, mungesa e përshtatshmërisë në ndërtesa kufizon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar.

Indirekt të dhënat e këtij studimi tregojnë një situatë akoma më të rëndë për sa i përket aksesit në shërbimet shëndetësore. Rezultojnë se pjesa më e madhe e ndërtesave të zgjedhura si qendra votimi që ishin të papërshtatura janë qendra shëndetësore. Një ndërhyrje e menjëhershme kërkohet në këtë drejtim duke patur parasysh se personat me aftësi të kufizuara kanë një nevojë shtesë për shërbimet shëndetësore.

Në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet parlamentare të 23 Qershorit 2013, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka nxjerrë Udhëzimin nr. 01, datë 12.12.2012 *“Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”*. Në këtë Udhëzim parashikohet si detyrim që vendndodhja e qendrës së votimit të jetë në katet e para të objekteve dhe njëkohësisht parashikohet detyrimi për të krijuar lehtësira për votimin e personave me aftësi të kufizuar dhe për të dërguar në KQZ listën e votuesve me aftësi të kufizuar brenda periudhës së rishikimit të ekstraktit të pëbërësve zgjedhor. Ky Udhëzim përmirëson ndjeshëm situatën ligjore të procesit, por duhet një zbatim efektiv i tij nga ana e qeverisjes vendore dhe një koordinim midis të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor.

²⁵ Raport Studimi, E drejta Zgjedhore për Zgjedhësit me Aftësi të Kufizuara, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Tiranë 2012.

Bazuar në Raportin e Studimit “Punësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri”²⁶, në Shqipëri rezulton një numër shumë i ulët të punësuarish me aftësi të kufizuar.

Si arsye të mungesës së punësimit mund të përmendet fakti shqetësues se personat me aftësi të kufizuara nuk dëshirojnë të punojnë dhe se preferojnë pagesën e aftësisë së kufizuar, në vend të asaj të fituar përmes punës, ndërsa ata që duan të punojnë, kanë frikë se mund të humbasin pagesën e aftësisë së kufizuar në momentin e gjetjes së një pune.

Kryesisht, ndër pengesat për t’u punësuar listohen paragjykimet nga punëdhënësit si dhe nga stafi rekrutues dhe ndër vështirësitë me të cilat personat me aftësi të kufizuara ndeshen kur ata janë të punësuar, u listuan mungesa e mjeteve dhe ambienteve të përshtatura, të cilat do të mundësonin aksesin dhe përshtatjen e tyre me vendin e punës. Pengesa të tjera janë ato ligjore, por edhe ato që burojnë nga vetë individët me aftësi të kufizuara e familjet e tyre, si edukimi i pamjaftueshëm, aplikimi jokorrekt, mungesa e përvojave të mëparshme në punë, mungesa e njohurive mbi intervistën dhe procesin e selektimit, por edhe pengesat për punësimin e tyre nga prindërit dhe familjet.

Gjithashtu, konstatohet se gati gjysma e personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës, ishin të punësuar në sektorin privat dhe një numër i vogël janë të punësuar në institucionet shtetërore. Ndërkaq, personat me aftësi të kufizuara mendore janë pothuajse totalisht të përjashtuar nga tregu i punës, pasi vetëm një prej bizneseve pjesëmarrës në studim deklaroi se kishte të punësuar vetëm një person me aftësi të kufizuara mendore. Gjithashtu, rezultojnë shumë pak persona me aftësi të kufizuara të punësuar me kohë të plotë.

Pjesëmarrësit me aftësi të kufizuara pohuan se ata nuk e ndjenin veten të diskriminuar në proceset e punës, pasi paga e tyre ishte e njëjtë me atë të kolegëve pa aftësi të kufizuara. Lidhur me gjendjen e përshtatshmërisë së vendit të punës, përgjithësisht vërehet se punëdhënësit kanë përshtatur vendin e punës nga pikëpamja ndërtimore dhe një pjesë e vogël e tyre ka siguruar transport të përshtatur. Ndërsa, përkthimi në gjuhën e shenjave, materialet në braille dhe informacioni i thjeshtëzuar mbeten në nivele të ulëta²⁷.

Nga vëzhgimi që i është bërë situatës së kategorive të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara, mund të thuhet se një kategori tjetër e aftësisë së kufizuar, përveç asaj në të dëgjim, e cila deri tani ka qënë më pak e dukshme, janë personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Gjatë vitit 2012 është miratuar ligji i ri për shëndetin mendor²⁸, i cili bën një

²⁶Raportin e Studimit “Punësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri” përgatitur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar– FSHDPAK me mbështetjen e USAID

²⁷Të dhëna të marra nga Raport Studimi “Punësimi i Personave me Aftësi Të Kufizuara në Shqipëri”, përgatitur dhe botuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar– FSHDPAK me mbështetjen e USAID, Tiranë 2011

²⁸Ligji nr. 44/2012, miratuarnë datën 19.04.2012.

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

harmonizim të parashikimeve për mosdiskriminimin në linjë me parashikimet e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mosdiskriminimi dhe garantimi i respektimit të parimit të barazisë kërkon jo vetëm barazi midis personave që kanë një aftësi të kufizuar dhe personave pa aftësi të kufizuara, por edhe brenda vetë kategorive të aftësisë së kufizuar.

KAPITULLI III

TRAJTIMI I ANKESAVE

3.1 Trajtimi i ankesave

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në **Ligjin nr.10 221, datë 4.2.2010 “Per Mbrojtjen nga Diskriminimi”**, u krijua si institucion qe “siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ne kompetence: të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi, të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligjit etj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me kërkesën e gjykatës që shqyrton çështjen, parashtron mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin, mund përfaqësojë ankuesin në organet gjyqësore në çështje civile me miratimin e tij, në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të këtij ligji.

Per shqyrtimin e çështjeve qe paraqiten pranë institucionit, ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme procedurat para KMD-së dhe gjykatës. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

3.2 Procedura e ankesave

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me paraqitjen e një ankese. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.

Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminimin si dhe shpjegimet dhe faktet që disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri. Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij. Komisioneri nuk vepron për ankesat anonime.

Nqs ankesa plotëson kushtet e ligjit për t'u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi te mëtejshem bazuar në nenin 33 te ligjit. Procedura e hetimit përfshin grumbullim informacioni lidhur me çështjen përmes kërkesës per shpjegime drejtuar ankuesit apo personit kundrejt te cilit eshte drejtuar ankesa, përmes inspektimeve apo seancave dëgjimore mes paleve. Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Pas analizimit të fakteve të grumbulluara bazuar në procedurën e hetimit Komisioneri del me vendim pas 90 ditëve nga data e ardhjes së ankeses, apo e seancës dëgjimore, nëse është zhvilluar një e tillë.

Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat të arsyeshëm për kryerjen e tyre.

Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brënda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brënda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.


Si mjet të fundit, veçanërisht kur subjekti fizik ose juridik nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brënda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij.

Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas Kodit të Procedures Civile.

3.3. Numri i ankesave

Në periudhën nga 1 janar 2012 deri në 31 dhjetor 2012, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë paraqitur 90 ankesa si dhe janë trajtuar 14 çështje te iniciuara kryesisht nga zyra e Komisionerit. Gjithashtu ka mbaruar procedura për shqyrtimin e 3 ankesave të mbartura nga viti 2011. Gjithsej kanë filluar procedurat për shqyrtimin e 107 çështjeve për diskriminim.

Ankesat për vitin 2011 dhe 2012



Siç shihet totali i numrit të ankesave të shqyrtuara dhe që janë në procedure në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011 është rritur me 6 here. Kjo rritje vjen si rezultat i shumë faktorëve: fushata ndërgjegjësuere në qytete të ndryshme të vendit, lidhja e memorandumeve të bashkëpunimit me bashkitë në vend, veprimtari të ndryshme të Komisionerit që kanë shërbyer për njohjen e Institucionit të Komisionerit si dhe të kompetencave të tij, bashkëpunimi me shoqërinë civile nëpërmjet projekteve të ndryshme etj.


Megjithatë mendojmë se ky numër mund të ishte me i lartë. Faktorë që ndikojnë janë psh: frika që kanë subjektet e diskriminuara se mos përkeqësojnë situatën dhe ndeshen me një përshkallëzim të sjelljes diskriminuese, apo një numri të vogël të ankesave të ardhura nga organizata me interesa legjitime në emër të subjekteve që pretendojnë diskriminim.

3.4. Ankuesit

Shumica e ankesave janë bërë nga individë të veçantë gjithsej 84. Nga keta 44 janë burra dhe 40 jane gra.

Duhet thënë se ka nje shpërndarje thuajse të barabarte gjinore të subjekteve që janë ankuar.


Ndarja gjinore e ankuesve



Gjithashtu 9 ankesa kanë ardhur nga organizata me interesa legjitime. Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e komunitetit LGBT, të personave me aftësi të kufizuara, të komunitetit rom, egjiptian etj. Falë bashkëpunimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe këtyre organizatave, për disa prej ankesave të ngritura prej tyre nga Komisioneri janë dhënë rekomandime, si dhe disa prej tyre janë zgjidhur me ndërmjetësim. Vlen të theksohet fakti se këto bashkëpunime kanë qënë mjaft të efektshme për evidentimin e rasteve të pretenduara për diskriminim dhe përmirësimin e kësaj situate

Ka pasur raste që organizatat kanë dhënë thjeshtë një indicie apo informacion dhe zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është vënë menjëherë në lëvizje për evidentimin e këtyre rasteve dhe zgjidhjen e tyre.

Ndonëse për vitin 2012 ka qënë një numër relativisht i vogël i ankesave të ardhura nga organizatat me interesa legjitime, duke u krahasuar me një vit më parë është vënë re një rritje e numrit të tyre.




3.5. Ankesat sipas shkaqeve të diskriminimit

Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Per Mbrojtjen nga Diskriminimi” rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër (neni 1).

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitin 2012 janë paraqitur ankesa për shkaqe të parashikuara në ligj si dhe ankesa për të cilat subjektet nuk janë në gjendje të identifikojnë shkaqet. Duhet theksuar se ligji ka parashikuar një listë të hapur të shkaqeve duke parashikuar edhe çdo shkak tjetër, duke patur parasysh këtu shkaqe që lidhen me cilësi individuale të personave etj. Duhet thënë që ankuesit e kanë të vështirë të identifikojnë shkakun apo cilësinë individuale për të cilin ato pretendojnë diskriminim.

Shpërndarja e ankesave sipas shkaqeve për vitin 2012 është: raca 36 ankesa, aftësia e kufizuar 19 ankesa, gjendja ekonomike 16 ankesa, orientimi seksual 7 ankesa, gjinia 2 ankesa, moshë 3 ankesa, bindjet politike 3 ankesa, etnia 3 ankesa, vendbanimi 2 ankesa, për cilësi të vecanta 5 ankesa, të paidentifikuara 6 ankesa, 1 ankesë për shkak të gjendjes shoqërore dhe përkatësisë prindërore.



- **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË RACËS**

Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të racës përbëjnë edhe numrin më të madh të ankesave, krahasuar me shkaqet e tjera, të ardhura pranë Komisionerit për vitin 2012. Duhet të theksohet fakti se këto ankesa janë tërhequr nga Komisioneri gjatë takimeve, ditëve të hapura, që Komisioneri ka organizuar në rrethe të ndryshme të vendit. Në projektin ditët e hapura, Komisioneri është takuar me komunitetin rom, ku ka informuar këtë komunitet lidhur me institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kompetencat dhe mënyrën se si duhet të ankohesh pranë institucionit të Komisionerit.

Nga ankesat e tërhequra vërejmë se pjestarë të këtij komuniteti ankohen se ndihen të diskriminuar në fushën e punësimit, strehimit dhe arsimit.

Duhet theksuar fakti se Komisioneri ka filluar kryesisht 6 çështje me pretendim diskriminim për shkak të races. Nga këto 3 raste, në bashkëpunim me institucionet përkatëse është arritur rivendosja e së drejtës së shkelur. Një çështje është mbyllur me konstatimin e mosdiskriminimit, ndërsa për një çështje procedura vazhdon.

- **Çështje1: Çështja ex-officio e studentëve Rom, lidhur me përjashtimin e tyre nga tarifat e rregjistrimit të studentëve, në Universitetin e Korçës.**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nisur procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes së gjashtë studentëve të komunitetit Rom, të cilët pretendojnë se nuk janë përjashtuar nga tarifat e rregjistrimit të këtij Universiteti, ashtu siç përcaktohet në vendimin nr. 423, datë

08.06.2011 dhe vendimin nr. 627, datë 31.08.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë”. Studentët kishin ngritur pretendimin se ishin rregjistruar në Universitet, por nuk i lejonin të hynin në provime pa paguar tarifën shkollore për vitin akademik përkatës.

Bazuar në bashkëpunimin me Shoqatën “Disutni Albania”, Shoqatën “Qëndistarët” dhe ndërmjetësimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Universitetin e Korçës Fan S. Noli, u arrit që të realizohej përfshirja e 11 studentëve rom, në listën e studentëve që përfitojnë përjashtimin nga pagesa e tarifës së shkollimit.

- **Çështje 2: C- Çështja ex-officio e komunitetit Rom, lidhur me bllokimin e mjeteve të punës nga ana e Bashkisë Tiranë.**

Bazuar në informacionin e dhënë, nga disa prej shoqatave të cilat mbrojnë interesat e komunitetit rom dhe egjiptian për bllokimin e mjeteve të punës të komunitetit rom nga Bashkia e Tiranës, Komisioneri nisi procedurat për ndjekjen ex-officio të kësaj çështje.

Mbështetur në nenin 32, gërma f), të Ligjit nr. 10 021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht *kompetenca e Komisionerit për të kryer rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*, si dhe duke patur si qëllim në vetëvete mirëbesimin dhe krijimin e marrëdhënieve sa më normale, të mbështetura në parimin e barazisë dhe aspak diskriminuese, ndërmjet Komunitetit Rom dhe institucioneve shtetërore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi **Rekomandoi:**

1. Duke marrë parasysh gjëndjen ekonomike të komunitetit rom, kushtet në të cilat jetojnë dhe mënyrën e sigurimit të të ardhurave, të shikohet mundësia nga ana e Bashkisë Tiranë, për punësimin e këtij komuniteti brënda aktiviteteve private të licensuara, në mënyrë që t’u krijohen kushtet për të siguruar jetesën bazuar në veprimtari të ligjshme.
2. Bazuar në legjislacionin në fuqi, ndërmjetësimin me institucionet e varësisë për të bërë të mundur ofrimin e ndihmës ekonomike për familjet rome, pasi bëhet fjalë për banorë të Bashkisë Tiranë.

- **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË AFTESISË SË KUFIZUAR**

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë paraqitur për vitin 2012, 19 ankesa për shkak të aftësisë së kufizuar. Nga këto 2 ankesa nuk janë pranuar pasi nuk plotësojnë kriteret ligjore për një shqyrtim të mëtejshëm, për 14 ankesa vazhdojnë procedurat, për 2 ankesa është marrë vendimi ku është konstatuar mosdiskriminim.

Ndërsa për një ankesë edhe pse nuk është konstatuar kemi gjetur diskriminim, Komisioneri, bazuar në nenin 3/7 i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”,* ka dhënë rekomandim për subjektin kundrejt të cilit ka ardhur ankesa, në mënyrë që të respektohen plotësisht kërkesat ligjore lidhur me të drejtat e PAK.

- **Cështje1**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e znj. S. L., kundër Hotel Tirana International, ku pretendohet për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Sipas shpjegimeve të dhëna nga znj. S. L., ajo pretendon se i është nënshtruar diskriminimit për shkak se nga ana e personelit të sigurisë së hotelit nuk i është lejuar koha e mjaftueshme për të hipur dhe për të zbritur nga makina e saj në ambientin para hyrjes së hotelit dhe është drejtuar nga ana e stafit drejt parkingut të hotelit që ndodhet nga ana e pasme e tij, ndërkohë që lejohen të kryhen këto veprime për zyrtarë ose për persona të rëndësishëm (sipas thënieve të personelit të sigurisë). Znj. L. pretendon se përpara hotelit nuk ka hapësira të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, ndërkohë që parkingu i hotelit nga ana e pasme është me pagesë.

Gjatë shqyrtimit të çështjes u inspektua në mjediset e hotel Tirana International dhe nuk u grumbulluan prova të moszbatimit të Rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave PAK. Nga inspektimi u vërejt se kishte vend të rezervuar për personat PAK dhe se, sipas tyre, parkimi i automjeteve për këto persona bëhej pa pagesë, si dhe kishte vend të përshtatur (rampa) për të bërë të mundur hyrjen në mjediset e brendshme të hotelit.

Ajo që u konstatua si mangësi (për shkak të rikonstruktimit të mjedisit) ishte mungesa e shenjave të veçanta të përshtatshmërisë së mjedisit të parkimit.

Bazuar në provat e administruara Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi mosdiskriminim ndaj znj. S. L., për shkak të aftësisë së kufizuar.

Megjithatë Komisioneri dha rekomandim që:

- *Hotel Tirana International brënda 30 ditëve të vendosë shenjat e veçanta të përshtatshmërisë së mjedisit të parkimit për personat PAK.*
- *Nga ana e personelit drejtues të kompanisë “Geci” sh.p.k duhet të sigurohet që të ketë instruksione më të sakta me kompanitë që kryejnë shërbime për llogari të hotelit mbi zbatimin e etikës dhe dhënien e kohës së mjaftueshme personave PAK për hipjen dhe zbritjen nga automjetet e tyre.*

- **ANKESA PER DISKRIMINIM PER SHKAK TE GJËNDJES EKONOMIKE**

Numri i ankesave të ardhura pranë Komisionerit me pretendim diskriminim për shkak të gjëndjes ekonomike dhe shoqërore është 16. Nga këto ankesa 9 ankesa nuk janë pranuar pasi nuk plotësojnë kërkesat e ligjit. Për 4 ankesa vazhdon procedura. Për 3 ankesa është konstatuar mosdiskriminim. Për një të një nga këto çështje pikërisht çështja e ndjekur kryesisht nga Komisioneri nuk janë gjetur elemente diskriminuese. Gjithsesi është dhënë rekomandim subjektit kundrejt të cilit është paraqitur ankesa, me synim përmirësimin e situatës dhe shmangien e rrethanave diskriminuese.

- **Cështje1**

Mbështetur në publikimet e bëra në shtypin e shkruar, nxënësit e shkollës “H. L.”, duhet të paguanin një tarifë prej dy mijë lekësh të reja për rregjistrimin e tyre në klasën e dhjetë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi se miratimi i tarifës së kontributit për shkollën, kishte kaluar të gjithë hapat e kërkuar nga udhëzimi nr. 29, datë 25.09.2007 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, fëmijët që rregjistroheshin dhe i përkisnin të njëjtës familje paguanin një tarifë më të ulët se fëmijët e tjerë, fëmijët të cilët çrregjistroheshin, në momentin e tërheqjes së dokumentacionit nga shkolla, bënë dhe tërheqjen e kontributit të dhënë, pagesa e kontributit, ishte bërë nga prindërit bazuar në vendimin e bordit të shkollës.

Ajo që ishte e rëndësishme ishte verifikimi i faktit se pagesa e këtyre kontributeve nuk ishte kusht për rregjistrimin në shkollë, siç pretendohesh në shkrim.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të administruara, Komisioneri vendosi: “konstatimin e mosdiskriminimit, ndaj nxënësve të shkollës “H. L.” dhe referuar situatës së krijuar, rekomandoi që të shmanget pagesa e kontributit në momentin e rregjistrimit në klasën e 10-të, të lihet në mundësinë e prindërve koha dhe shuma e pagesës vullnetare të kontributit, të mos ketë raste të penalizimit të nxënësve nëse nuk shprehin gadishmëri për çdo lloj arsye, për të dhënë kontributin për shkollën.

- **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL**

Gjatë vitit 2012 Komisioneri ka shqyrtuar 7 ankesa me pretendim diskriminim për shkak të orientimit seksual. Nga këto për 2 ankesa është marrë vendim mosdiskriminimi, një ankesë nuk është pranuar, një ankesë është në proces shqyrtimi, ndërsa për dy prej ankesave është konstatuar diskriminim.

Cështje1

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e bërë nga Ambasada PINK/LGBT PRO Shqipëri me Nr. Regjistri 39, datë 08.11.2012, kundër autorëve të librit “Mjekësia Ligjore”, z. S. M. dhe z. B. Ç., në të cilën pretendohet se tekstet universitare diskriminojnë dhe paragjykojnë hapur komunitetin LGBT në Shqipëri.

Sipas ankesës së sipërpërmendur, diskriminimi i komunitetit LGBT konsiston faktin se në tekstin e librit “Mjekësia Ligjore”, përdoren terma dhe informacione diskriminuese, jo shkencore dhe fyese për komunitetin LGBT, si dhe studentët e Fakulteteve të Mjekësisë dhe Drejtësisë të Universitetit të Tiranës po marrin njohuri të gabuara, të cilat do të ndikojnë në formimin e tyre si mjekë dhe juristë të ardhshëm.

Komisioneri pasi u njoh me përmbajtjen e tekstit në fjalë dhe pasi vlerësoi se përmbajtja e tekstit në fjalë përbën shqetësim, jep informacion të gabuar, krijon ndjenjën e fyerjes dhe cënon dinjitetin e këtij komuniteti duke bërë që dhe perceptimi nga personat e tjerë për këtë kategori të jetë diskriminues, vendosi:

1. Konstatimin e diskriminimit përmes përmbajtjes së tekstit “Mjekësia Ligjore” me autorë Prof.Dr. S.M. dhe Prof.Dr. B.Ç., për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
2. Detyrimin e autorëve si persona të cilët kanë konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, që brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim të bëjnë modifikimin ose në rastin kur nuk është i mundur të bëjnë heqjen nga tregu dhe nga bibliotekat e institucioneve të këtij libri.
3. Detyrohen autorët, Prof.Dr. S.M. dhe Prof.Dr. B.Ç., që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi duke depozituar dhe një kopje të librit me ndryshimet e bëra.

Cështje2

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndoqi debatin e zhvilluar me temë “Parada Pro Gay dhe Kundërshtarët”, transmetuar në emisionin Opinion të datës 02.04.2012, emision i transmetuar në Televizionin Kombëtar Klan.

Duke marrë shkas nga debati i zhvilluar në këtë emision dhe gjuha e përdorur nga njëri prej të ftuarve, z. M. B, i ftuar në cilësinë e Nënkryetarit të Partisë Lëvizja e Legalitetit, Komisioneri, me urdhrin nr. 19, datë 05. 04. 2012, filloi procedimin administrativ ndaj tij.

Pas një analize ligjore, në bazë të nenit 32, gërma “c”, si dhe nenit 33, pikat 10 dhe 11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe duke mbajtur parasysh qëndrimet e fundit të Gjykatës së Strasburgut, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi:

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

- Deklaratat e lëshuara nga z. M. B. në debatin e zhvilluar në emisionin “Opinion” të datës 04. 02. 2012, të transmetuar në Televizionin Kombëtar Klan, janë diskriminuese sipas parashikimit të nenit 3, pika 2 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pasi ato paragjykojnë dinjitetin dhe çënojnë të drejtën e jetës, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetin gjinor.
- Detyrimin e z. M. B. si personi i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të kërkojë falje publikisht dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës e cila prodhon efektin e nxitjes, përhapjes, nxitjen e urrejtjes apo të tjera forma të diskriminimit kundër personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre.
- Detyrohet z. M.B. që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
- Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikime të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

Z.M.B. bazuar në vendimin e Komisionerit, kërkoj falje publike në nje nga gazetate me tirazh me te madh dhe informoi në mënyre shkresore Komisionerin për këte.

• **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË GJINISË**

Për vitin 2012, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi 2 ankesa me pretendim diskriminimit për shkak të gjinisë, nga të cilat për një rast është duke vazhduar procedura e shqyrtimit, një ankesë është pushuar për pamundësi të sigurimit të provave. Gjithashtu edhe në ankesa të tjera të shqyrtuara ka batur element të diskriminimit gjinor.

Cështje1

Ankuesi pretendon se i është nënshtruar diskriminimit për shkak se katedra në të cilën pretendon të punësohet përbëhet vetëm nga meshkuj të cilët nuk duan që të punësohet pedagoge femër. I.K pretendon se po pengohet për tu punësuar dhe nuk po i njihen kualifikimet akademike për shkak të veprimtarisë së saj denoncuese dhe për frymën e lartë të kritikës ndaj qëndrimeve dhe veprimeve të padrejta të rektoratit nëpërmjet shtypit të shkruar dhe denoncimeve në MASH. Dosja është në shqyrtim.

Cështje2

Znj.S. Ç ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi një ankesë kundër z.A. K dhe znj.B. B në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjinisë si dhe për shkak të denocimit nga ana e saj të drejtuesve për afera korruptive. Ankuesja shprehet se ka bërë denoncime për afera korruptive në institucionin ku është e punësuar që sipas saj, është institucion shtetëror dhe trajtohet si institucion privat nga e z.A. K dhe Znj.B B, dhe

nga ky shkak ankuesja pretendon se diskriminohet me mënyra të ndryshme. (trajtuar me poshtë si ankese ne fushën e punesimit)

Gjate shqyrtimit te kësaj ankese u vunë re edhe elementë të diskriminimit gjinor. Përfaqesuesja ligjore e institucionit privat H.F, pohon në seancën degjimore se: *“Në shkollën tonë punonjëset femra duhet të veshin uniformë, ndërsa punonjësit meshkuj nuk kanë uniformëmësuesve meshkuj nuk u është kërkuar uniforma, pasi i kërkohet vetëm disa prej tyre”*, ndërkohë me dt.16 Mars 2011 me shkrese nr.prot.392,znj. B. B. drejtore e shkollës , znj.L.N. zv/drejtore dhe znj. D. T. shefe e departamentit, i kanë propozuar Drejtorit të Përgjithshëm z.A.K. masë disiplinore “vërejtje me shkrim” për mësuesen S.C. me argumentët: *Nga data 06.09.2010 zhvillon mësim pa përparëse në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Institutit dhe Udhëzimit përkatës nga MASH, për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore.*

Shihet qarte trajtimi i pabarabarte gjinor i mësuesve te shkollës nga drejtuesit e saj.

Kjo është një ndër elementët përbërës të vendimit të marrë nga Komisioneri ku është konstatuar diskriminim.

- **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË GJENDJES SHOQËRORE DHE PËRKATËSISË PRINDËRORE**

Për vitin 2012, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi 1 çeshtje me pretendim diskriminim për shkak të gjendjes shoqerore dhe përkatësisë prinderore, per te cilen është marrë vendim për diskriminim.

Çështje1

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u vu në dijeni nga publikimet në media, mbi pretendimin për keqtrajtimin psikologjik të tre grave të dhunuara, të cilat kanë banuar pranë Qendrës Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe aktualisht e kanë braktisur Qendrën, si pasojë e dhunës psikologjike të ushtruar mbi to nga ana e drejtoreshës së kësaj qendre.

Pranë kësaj qendre, niveli i sigurisë është konsideruar i mjaftueshëm vetëm në kufizimin e telefonatave me familjen²⁹ dhe “sekuestrimin” e celularëve të përfitueseve për të mos komunikuar me të afërmit, ndërkohë që ato janë të lira të dalin nga institucioni, të punojnë apo të shoqërojnë fëmijët në shkolla.

Përfitueseve pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje nuk u ofrohet ndihmë psikologjike nga ana e një psikologu, pavarësisht se ato e kanë jashtëzakonisht të nevojshme një ndihmë të tillë, si pasojë e dhunës fizike dhe asaj psikologjike që është ushtruar mbi to, nga bashkëshortët e tyre. Shërbimet psikologjike janë

²⁹Përfitueset pohojnë se u lejohej vetëm një telefonatë në muaj me familjarët, e cila survejohej nga persona të ngarkuar nga drejtuesja e institucionit.

parashikuar si shërbime shtesë që mund të ofrohen për këtë Qendër, në bazë të Standartit 1, të Vendimit nr. 505, datë 13.07.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standarteve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”.

Shumë prej përfitueseve në këtë qendër janë palë në proçese gjyqësore për zgjidhje martese apo për lëshim urdhër mbrojtjeje nga gjykata, ndërkohë që asistenca ligjore nga Qendra mungon, për vetë faktin se në organikën e kësaj qendre nuk parashikohet pozicioni “jurist”. Pavarësisht gjendjes tepër të rëndë ekonomike të tyre, përfitueset paguajnë avokatë, ndërkohë që ekzistenca e juristit të Qendrës mund t’i shmangte këto vështirësi. Sërisht vlen të përmendim faktin se edhe shërbimet juridike janë parashikuar si shërbime shtesë që mund të ofrohen për këtë Qendër, në bazë të Standartit 1, të Vendimit nr. 505, datë 13.07.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standarteve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”

Fëmijët e përfitueseve pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës, janë përjashtuar nga gëzimi i të drejtave të tyre për t’u trajtuar njëjloj si fëmijë të tjerë jashtë kësaj Qendre, për shkak të gjendjes në të cilën ndodhen nënat e tyre. Edhe pse, nëpërmjet strukturës organike të miratuar me Urdhërin nr. 36, datë 18.03.2011, të Kryeministrit, fëmijëve të kësaj qendre u janë dhënë të gjitha mundësitë që të gëzojnë të njëjtat të drejta me fëmijët e tjerë jashtë Qendres, duke iu vënë në dispozicion të tyre 2 edukatore, këto të fundit nuk janë të disponueshme për ta, dhe rolin e tyre e luajnë shpesh here punonjësja sociale apo kujdestaret.

Pasi shqyrtoi të gjitha provat e mbledhura prej tij, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi:

1. Konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes shoqërore të përfitueseve që banojnë pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje.
2. Konstatimin e diskriminimit për shkak të përkatësisë prindërore të fëmijëve të përfitueseve që banojnë pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje.
3. Rekomandoi marrjen e masave të menjëhershme nga institucionet kompetente, për t’iu siguruar këtyre përfitueseve asistencën ligjore, psikologjike dhe nivelin e mjaftueshëm të sigurisë për jetën dhe shëndetin e tyre.
4. Rekomandoi marrjen e masave të menjëherëshme nga institucionet kompetente, për t’iu siguruar fëmijëve që banojnë në këtë qendër, trajtim të përshtatshëm edukativ dhe përkujdesjen e mjaftueshme me kohë të plotë, nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për të kryer këtë detyrë.

Institucioni ka reaguar menjëherë përmes zëvendësimit të Drejtores së Qendrës me një person të diplomuar si punonjëse sociale, përmirësimit të rregullores së funksionimit dhe ofrimit korrekt të shërbimeve të parashikuara.

- **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË MOSHËS**

Ankesat e paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për shkak të moshës gjatë vitit 2012, kanë qënë 3. Pasi u shqyrtuan nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit, për njëjërën prej ankesave nuk u konstatua diskriminim, ndërsa për dy të tjerat vazhdojnë procedurat hetimore nga ana e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Rastet e diskriminimit për shkak të moshës të cilat janë paraqitur para Komisionerit kanë qënë raste që kishin të bënin me trajtimin e moshës së tretë, si dhe rasti i dhunimit të një fëmije nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Cështje1

Mbështetur në publikimet e bëra në shtypin e shkruar të çështjes së të moshuarve të “Shtëpisë së të moshuarve” Ali Demi Komisioneri nisi procedurat hetimore, lidhur me monitorimin e kushteve të jetesës së të moshuarve, të transferuar në shoqatën humanitare “K.”.

Sipas informacionit të marrë në shtypin e shkruar, kushtet nuk i plotësonin standartet e jetesës, si dhe trajtimi i të moshuarve nuk ishte njerëzor nga drejtori i ri dhe stafi i “Shtëpisë së të moshuarve”. Gjatë hetimeve të realizuara dhe në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi se; të moshuarit ishin transferuar në ambjentet e shoqatës humanitare “K.” përkohësisht, deri në përfundim të punimeve të “Shtëpisë së të moshuarve” në rrugën Ali Demi; përmes një vizite në grup, drejtori i “Shtëpisë së të moshuarve” z. H. K., përpara transferimit ishte konsultuar me të moshuarit dhe kishte marrë aprovimin e tyre për transferimin në shoqatën humanitare “K.”; gjatë inspektimit, nuk u evidentuan sjellje shqetësuese nga ana e stafit të “Shtëpisë së të moshuarve” dhe nuk u konstatuan kushte të cilat nuk plotësonin standartet e jetesës; të moshuarit kishin hartuar një deklaratë proteste, drejtuar drejtores së përgjithme të SHSSH-së, znj. K. M. dhe A. të P. z. I. T., në të cilën shprehnin shqetësimin e tyre për publikimin e atij informacioni në shtypin e shkruar, për të cilin nuk ishin dakort.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të administruara, Komisioneri, vendosi konstatimin e mosdiskriminimit, ndaj të moshuarve të “Shtëpisë së të moshuarve” Tiranë, të transferuar në shoqatën humanitare “Kuka”, në Tufinë.

- **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE**

Gjatë vitit 2012 janë paraqitur 3 ankesa për diskriminim, me shkak të bindjeve politike. Dy prej tyre janë shqyrtuar dhe është arritur në përfundimin se nuk kemi të bëjmë me raste të diskriminimit, ndërsa për njëjërën vazhdon procedura hetimore. Për ankesat e paraqitura me këtë shkak, gjatë hetimit për të vërtetuar objektin e pretendimit janë hasur vështirësi pasi ishte e pamundur për të vërtetuar trajtimin ndryshe për shkak të bindjeve politike të subjektit ankues apo të subjekteve ndaj të cilëve ishte drejtuar ankesa.

Cështje1

Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shtetasi G. R., paraqiti ankesën e tij, në të cilën pretendonte se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike dhe filozofike

Ankuesi pas kthimit të tij në Shqipëri ishte regjistruar si punëkërkuar i papunë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Tiranë. Gjatë kësaj periudhe ai kishte marrë vetëm dy oferta pune, të cilat nuk kanë qënë të përshtatshme me profilin për të ai është arsimuar. Ankuesi ishte paraqitur sërish në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë për të marrë një vërtetim papunësie, gjithashtu ka pyetur për ndonjë vend të lirë pune, por nga nënpunësi përgjegjës pretendohet se, ka marrë përgjigjen se për profilin e tij nuk ka vend pune të lirë. Një tjetër nënpunës prezent pretendohet se i ka thënë “...duhet tesera e partisë për të hyrë në punë ”.

Nga provat, informacionet e mbledhura dhe konsultimi me legjislacionin në fuqi, përse i përket punëkërkuarve të papunë, rezultoi se nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, subjektit ankues i janë ofruar të gjitha ofertat e punës të cilat zyra ka pasur në dispozicion, pavarësisht se ato nuk kanë qënë në profilin e punës së tij; i janë ofruar kurse formimi profesional dhe projekte për nxitjen e punësimit por ai nuk ka qënë i gatshëm ti ndjekë.

Përse i përket pretendimit të z. G. R. se një nga nënpunësit e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë, është shprehur se “duhet tesera e partisë për të hyrë në punë” , nuk u arrit të siguroheshin fakte dhe prova, të cilat të vërtetonin pretendimin e subjektit ankues. Për këtë arsye Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi mosdiskriminim, për shkak të bindjeve politike dhe filozofike, si kriter për punësimin e tij nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë për rastin në fjalë.

- **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË ETNISË**

Për vitin 2012 në ndryshim me vitin paraardhës, është vënë re një numër ankesash të cilat kishin të bënin me diskriminimin për shkak të etnisë. Këto raste ndonëse të pakta në numër kanë pasur vëmendjen e duhur nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjatë vitit 2012 janë trajtuar 3 ankesa që kishin të bënin me pretendimin për diskriminimin e sipërcituar, për të cilat vazhdojnë procedurat hetimore dhe po trajtohen nga Komisioneri.

Cështje1

Një ndër ankesat me pretendim për diskriminimin, me shkak etnisë dhe gjuhës, është paraqitur nga Minoriteti Maqedonas në Komunën Liqenas. Kjo ankesë ka të bëjë me një artikull të botuar në një nga mediat e shkruara ku pretendohet se është përdorur gjuhë fyese nga autori i tekstit. Komisioneri për këtë rast ka nisur procedurat e caktuara nga ligji dhe

është në përfundim të hetimeve, të cilat së shpejti do të përfundojnë dhe do të hartohet vendimi i bazuar në provat e grumbulluara.

- **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË VENDBANIMIT**

Gjatë vitit 2012 janë paraqitur 2 ankesa me pretendim diskriminim për shkak të vendbanimit. Ankesat i referohen mungesës së ofrimit të shërbimeve nga pushteti vendor, si kanalizime apo transporti publik. Për këto ankesa kanë nisur procedurat për ndjekjen kryesisht të tyre, bazuar në informacione që Komisioneri ka marrë në takimet e zhvilluara me komunitetin për të bërë të mundur njohjen e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” nga ana e tij. Rastet vazhdojnë të trajtohen dhe për to po kryhen të gjitha procedurat e caktuara nga ligji.

Cështje1

Në takimet e zhvilluara me komunitetin e zonës së ish Kënetës në Durrës me qëllim njohjen nga ky komunitet i të drejtave që u jep ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori informacion prej tyre për disa raste me pretendim diskriminim për shkak të vendbanimit. Çështjet e parashtruara nga banorët e kësaj zone kishin të bënin me kanalizimet dhe transportin, të cilat pretendoheshin se mungonin dhe nuk ishte marrë asnjë masë për të bërë të mundur zgjidhjen e kësaj situatë nga Bashkia e Durrësit. Për këto raste Zyra e Komisionerit, bazuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, po ndjek të gjitha procedurat për hetimin e çështjeve.

- **ANKESA PËR DISKRIMINIM PËR SHKAK TË CILËSIVE TË VEÇANTA**

Rastet me pretendimin për diskriminim për shkak të cilësive të veçanta për vitin 2012 kanë qënë 5, për 2 prej të cilave është konstatuar diskriminim, 1 nuk është pranuar pasi për të ishte dhënë një vendim i mëparshëm, 1 ankesë është pezulluar përkohësisht pasi është ngritur padi në Gjykatë nga subjekti ankues dhe nuk është saktësuar akoma objekti i padisë, një ankesë nuk është pranuar për shkak se ishte në kundërshtim me dispozitat e ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Përgjithësisht ankesat e paraqitura me këtë shkak pranë Komisionerit pretendojnë diskriminim në fushën e punësimit.

Cështje1

Sipas shpjegimeve të dhëna nga znj. F. K, rezulton se ajo ka qënë e punësuar pranë DRSH Fier që nga viti 1984. Marrëdhëniet e punës kanë vazhduar normalisht deri në kohën kur ka denoncuar shkeljet pranë këtij institucioni. Ankuesja shprehet se ka bërë denoncime në disa institucione për emërim të padrejtë të z. F. Ç, në pozicionin e zv/drejtorit ekonomik dhe nga ky shkak ankuesja pretendon se është diskriminuar dhe viktimizuar.

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DRSH Fier në muajin Mars 2011 ka lëshuar Urdhërin për shkarkimin e punonjësës F.K. nga detyra e mëparshme dhe emërimin e saj në një pozicionin pa kualifikimin përkatës dhe me një pagë më të ulët. DRSH Fier justifikon shkarkimin e punonjësës me motivacionin e shkeljes së rregullave të etikës në Administratën Publike si dhe për të përmirësuar ecurinë e punës në sektorin e informacionit shëndetësor.

DRSH Fier gjatë gjithë procesit të shqyrtimit të ankesës nga ana e KMD nuk arriti të vendosë në dispozicion të Komisionerit prova mbi thyerjen e etikës apo përmirësimin të punës në sektorin që drejtohej nga znj.F.K.

Subjekti ankues në shoqërim të ankesës depozitoi pranë Komisionerit të gjitha shkresat drejtuar institucioneve të ndryshme të cilat faktojnë shqetësimet e ngritura prej saj për shkeljet e ndodhura.

Në të tri këto shkresa denoncohet fakti nga ana e znj.F.K, për emërimin pa arsimin përkatës të z.F.Ç, si zv/drejtor ekonomik, fakt ky i konstatuar dhe nga kontrolli i ushtruar nga KLSH në DRSH Fier, i cili rekomandon Ministrisë së Shëndetësisë marrjen e masës administrative “Largim nga detyra të z.F.Ç, dhe kërkimin në rrugë ligjore të kthimit të dëmit ekonomik të shkaktuar nga pagesa e kundërligjshme”.

Faktin e emërimit të padrejtë të z.F. Ç në postin e zv/drejtor ekonomik, e ka pranuar dhe vetë drejtori i DRSH Fier i cili ka pranuar rekomandimin e raportit të KLSH duke bërë largimin e z. F.Ç nga posti i zv/drejtor ekonomik dhe duke e emëruar në postin që deri atëherë mbahej nga znj. F.K.

Nga sa më sipër rezulton se pretendimet e znj.F. K kanë qenë të drejta dhe Urdhri për shkarkimin nga detyra e znj.F. K si dhe Vendimi për emërimin e z.F. Ç. në pozicionin e znj.F. K. është bërë si reagim ndaj denoncimeve të bëra nga kjo e fundit.

Përsa më sipër, vërejmë se për emërimin e znj. F.K. në pozicionin nd/epidemiologe, nuk janë respektuar procedurat e punësimit të punonjësve mbi bazën e konkurrencës si dhe janë përdorur kritere të tjera duke e trajtuar ndryshe nga kandidatët e tjerë. Trajtimi ndryshe vërtetohet dhe nga praktika e punësimit e ndjekur nga DRSh Fier për punësimin e punonjësit z. K. K, në të njëjtin pozicion pune me atë të znj. F.K.

Urdhri për shkarkimin e znj.F.K. nga detyra e përgjegjësës së informacionit shëndetësor dhe emërimit të saj në pozicionin e N/Epidemiologe pranë Qendrës Shëndetësore P, nuk ka marrë parasysh diplomën e shkollës së lartë së znj. F.K. por i është referuar eksperiencës së punës që ka pasur ankuesja më përpara, gjithashtu dhe për trajtimin në pagë nuk është pasur parasysh diferencimi në pagë pasi punonjësja do të trajtohej si punonjëse me arsim të mesëm. *Duke e emëruar në një pozicion jo me arsim përkatës znj.F.K, vendoset në një pozicion jo të garantuar pasi mund të pushohet në të ardhme pikërisht për këto arsye.*

Për këto arsye, Komisioneri pasi shqyrtoi provat e grumbulluara, konstatoi se ndaj ankueses ishte ushtruar diskriminim, për shkak të denoncimeve të bëra prej saj. Gjithashtu

Komisioneri rekomandoi DRSH Fier dhe drejtuesit e këtij institucioni, rikthimin e ankueses në punë dhe raportimin brënda një afati të caktuar për masat e marra për zbatimin e vendimit.

Nga ana e DRSH Fier nuk u morr asnjë masë për përmirësimin e kësaj situatë dhe zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit.

Bazuar në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri vendosi masën administrative, gjobë për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji. Në përgjigje të vendimit me gjobë DRSH Fier ka njoftuar Komisionerin se do bëjë ankim në gjykatë sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin Shqiptar.

• **ANKESA PËR DISKRIMINIM PA SHKAK TË CILËSUAR**

Gjatë vitit 2012 ka pasur ankesa për diskriminim, në të cilat nuk ishte deklaruar shkak i diskriminimit. Kjo mendohet të vije kryesisht për arsyen se paditësit nuk arrijnë të evidentojnë qartë shkakun e diskriminimit. Ankesat e paraqitura pa një shkak diskriminimi të cilësuar janë 6, 1 prej tyre ka refuzuar të vazhdojë procedurat e mëtejshme të shqyrtimit të ankesës, 1 ankesë nuk është pranuar pasi nuk plotëson kriteret e ligjit, ndërsa për 4 prej tyre vazhdojnë procedurat hetimore.


Cështje1

Znj.D.T.në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka deklaruar se punon si promovuese e medikamenteve nëpër farmaci, pranë një Kompanie Farmaceutike B. d.o.o., që prej muajit tetor, të vitit 2002. Ankuesja pretendon se drejtuesja e kësaj kompanie ushtron dhunë sistematike, psikologjike me qëllim që znj.D. T të japë dorëheqjen nga pozicioni i punës së saj. Sipas saj, drejtuesja e kompanisë znj.O.J, në mënyrë krejt të padrejtë i ka komunikuar në rrugë elektronike (me e-mail) një vërejtje “paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës”, e cila sipas ankueses është krejt e pabazuar në ligj dhe në Kodin e Punës. Ankuesja thekson se një gjendje e tillë ka patur ndikim negativ, jo vetëm tek ajo personalisht, por edhe tek femijët e saj. Znj.D. T. thekson se në zyrën ku ajo punon të gjithë punonjësit janë me arsim të lartë dhe kryejnë të njëjtat detyra, ndërkohë që pagesa e saj është më e ulët krahasuar me të tjerët. Ankuesja pretendon se është e vetmja punonjëse që zbaton detyrat e dhëna nga eprorët me përpikmëri, por drejtuesja e kompanisë e shmang totalisht.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga Znj.D.T., pretendohet se ajo trajtohet ndryshe nga punonjësit e tjerë që kryejnë të njëjtën punë me të, pavarësisht se ajo nuk identifikon shkakun e këtij trajtimi të ndryshëm dhe këtij presioni psikologjik që ushtrohet ndaj saj.

3.6 FUSHAT NË TË CILAT JANË PARAQITUR ANKESAT

Ankesat e pranuar gjatë vitit 2012 duke ju referuar fushës së të mirave dhe shërbimeve (74 %), punësimit (18 %) dhe arsimit (8 %).



• **MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE**

Ankesat në fushën e të mirave dhe shërbimeve kanë qënë më të mëdha në numër, referuar dy fushave të tjera. Duke qënë se kjo fushë përfshin një gamë më të gjërë të mbulimit, pasi në fushën e të mirave dhe shërbimeve përfshihen përfitimi i të mirave dhe shërbimeve të ofruar nga administrata publike, kryesisht ankesat e paraqitura në këtë fushë kanë të bëjnë me shërbimet të cilat nuk u janë ofruar nga njësitë vendore (p.sh. personat me aftësi të kufizuara pretendojnë se njësitë vendore nuk kanë përshtatur mjediset e vendbanimit ku jetojnë për personat me aftësi të kufizuara), subjekteve private, shëndetësia, administrata publike etj. Përgjithësisht ankesat kanë pasur të bëjnë me përshtatjen e arsyeshme, vonesat në pagesat e pensioneve të invaliditetit, vonesat në rimbursimin e energjisë elektrike dhe telefonike nga ana e njësive vendore etj. Kjo është dhe arsyeja se kjo fushë përmbledh 74 % të ankesave të përgjithshme.

• **MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI NË FUSHËN E PUNËSIMIT**

Referuar ankesave të paraqitura në këtë fushë, të cilat përbëjnë rreth 18 % të numrit të përgjithshëm të ankesave për vitin 2012, vlen të përmendet fakti se kryesisht këto ankesa

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

kanë të bëjnë me procedurat e ndjekura nga institucione të ndryshme në lidhje me punësimin në administratë, po nuk kanë qënë të pakta ankesat e paraqitura ndaj subjekteve private, lidhur me trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes

ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Cështje1

Znj.S.Ç ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi një ankesë kundër z.A.K. dhe znj.B.B. në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjinisë si dhe për shkak të denocimit nga ana e saj të drejtuesve për afera korruptive. Ankuesja shprehet se ka bërë denoncime për afera korruptive në institucionin ku është e punësuar që sipas saj, është institucion shtetëror dhe trajtohet si institucion privat nga e z.A. K dhe Znj.B B, dhe për këtë ankuesja pretendon se diskriminohet me mënyra të ndryshme:

- Trajtim i pabarabartë me kolegët në rritjen e pagës dhe në orët shtesë.
- Përfjashtim nga aktivitetet që kryen shkolla si brenda dhe jashtë saj.
- Përfjashtuar nga pagesa në ditët e korigjimit të provimit të maturës shtetërore.
- Dhunë psikologjike nga ana e drejtoreshës znj. B. B.
- Përfjashtim i djalit të saj z. F. Ç. nga dhënia e dëftesës së vitit të katërt, si dhe dhunë psikologjike në peridhën e nxjerrjes së rezultatit të provimit. Tendencë për ta përfjashtuar nga shkolla, si dhe vendosje note pa qënë prezent.

Komisioneri bazuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, grumbulloi dhe analizoi një sërë faktesh dhe provash mbi çështjen.

Gjatë inspektimeve në këtë institucion është mundur të sigurohen vlerësimet për vitet 2010-2011, 2007-2008, 2004-2005, pasi vlerësimet për vitin 2009-2010 nuk u vunë në dispozicion, me pretendimin se nuk është bërë vlerësim për asnjë punonjës

Vlerësimi i punës për punonjësit e institucionit është parashikuar në Rregulloren e Menaxhimit të Stafit. Parashikohet vlerësim për një periudhë 12 mujore dhe realizohet bazuar në vlerësimin e punës nga shefi i departamentit si dhe nga tërheqja e mendimit të punonjësve.

Mosvënia në dispozicion e vlerësimit për vitin 2009-2010 me justifikimin se nuk është bërë vlerësim pune për asnjë punonjës për atë periudhë, vite kur pretendohet nga drejtuesit e institucionit që ka ndryshuar sjellja e ankueses, na çon në konkluzionin se:

Drejtesit e Institucionit nuk mund të provojnë ndryshimin e sjelljes së ankueses, gjë që pretendohet nga ato. Bazuar edhe në vendimin Nr.33, datë 12.09.2007 të Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilit pas prezumimit për diskriminim nga ana e punëmarrësit, i takon punëdhënësit të provojë të kundërten, do të thotë që nuk e ka diskriminuar punëmarrësin. Ky vendim përcaktoi përmbyesjen e barrës së provës për rastet e diskriminimit në punësim.

Gjatë shqyrtimit të vlerësimeve të mësipërme vihet re se vlerësimi për vitit 2010-2011 ndryshon rrënjësisht nga vlerësimet e mëparshme.

Në periudhën Mars 2011 me shkresë nr.prot...., znj.B. B, drejtuese dhe dy drejtues të tjerë, i kanë propozuar Drejtorit të Përgjithshëm z.A K masë disiplinore “vërejtje me shkrim” për ankuesen znj.S.Ç. Sipas hetimit kjo masë disiplinore është marrë në kundërshtim të hapur me procedurën e parashikuar në rregulloren e menaxhimit të stafit. Ankuesja znj.S Ç nuk ka marrë asnjë përgjigje nga z.A. K për observacionin drejtuar këtij të fundit me shkresë në periudhën Mars 2011, mbi dhënien e njoftimit për fillimin e ecurisë disiplinore si dhe ankesë me pretendim diskriminimi përfshirë në këtë observacion.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi në nenin 13/c, “detyrimet e punëdhënësit”, parashikon se: Punëdhënësi është i detyruar: “t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre”

Në përfundim të hetimit, Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit të znj.S Ç, nga z.A. K dhe znj.B. B, për shkak të denocimit të tyre nga ana e saj si dhe rekomandoi marrjen e të gjitha masave që znj.S.Ç të trajtohet njëjloj me kolegët e tjerë, të bëhet vlerësimi i punës sipas të njëjtave procedura me punonjësit e tjerë si dhe marrjen e të gjitha masave për vendosjen e një frymëbashkëpunimi të znj.S. Ç dhe kolegëve të tjerë, për sa kohë ankuesja të jetë pjesë e atij institucioni.

Rekomandimi i Komisionerit nuk është zbatuar nga ana e subjektit që ka kryer diskriminimin. Komisioneri ka vendosur sanksion me gjobë për 2 subjektet sipas vendimit. Gjopa është ankimuar në Gjykate nga subjekti ndërkohë që Gjykata ka rrezuar padinë e tij.

- **MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI NË FUSHËN E ARSIMIT**

Fusha e arsimit ka qënë ajo për të cilën nuk ka pasur numër të madh ankesash në krahasim me dy fushat e tjera që parashikon ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Vlen të theksohet se fusha e arsimit ka qënë një nga fushat ku ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi është prezantuar fillimisht dhe njohja me ligjin antidiskriminim ka qënë më e hershme në këtë fushë, në sajë të projekteve që fillimisht kanë nisur me arsimin parauniversitar dhe aktore të ndryshëm si mësues, psikolog, drejtues të institucioneve arsimore.

Cështje1

Çështja e gjashtë studentëve të komunitetit Rom, të cilët pretendojnë se nuk janë përjashtuar nga tarifatat e rregjistrimit të këtij Universiteti, ashtu siç përcaktohet në vendimin nr. 423, datë 08.06.2011 dhe vendimin nr. 627, datë 31.08.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, është një çështje që i përket fushës së arsimit.

(Çështja është analizuar me siper si çështje me shkak racën)

Cështje2

Në kuadër të problematikave që hasin personat me aftësi të kufizuara, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë - ANAD, solli në vëmendjen e Komisionerit problemin e dy studentëve me aftësi të kufizuar në dëgjim, të cilët studionin në një universitet, por procesi i mësimdhënies nuk ishte i përshtatur. Për këtë çështje, Komisioneri rekomandoi marrjen e masave për sigurimin e përshtatjes së arsyeshme për të garantuar në këtë mënyrë ushtrimin në mënyrë të barabartë të së drejtës për arsimim të këtyre studentëve me studentet e tjerë. Ofrimi i shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtën e arsimimit për personat me aftësi të kufizuara duhet të jetë efektive dhe të mos mbetet vetëm një parashikim ligjor.

3.7 SUBJEKTET KUNDËR TË CILËVE ËSHTË PARAQITUR ANKESA

Ankesat e paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përgjithësisht janë drejtuar kundër administratës publike, qendrore apo pushtetit vendor.

Numri i ankesave kundër sektorit privat, në krahasim me atë publik mbetet i vogël, por me tendence rritje krahasuar me vitet e kaluara. Duke qënë se administrata publike ofron një sërë shërbimesh për qytetarin dhe përgjithësisht është ai sektor me të cilin qytetari përballet më shpesh, është dhe sektori kundër të cilit edhe numri i ankesave është dhe më i madh. Përgjithësisht ankesat kundër sektorit publik kanë të bëjnë me punësimin, përfitimin e pensioneve të invaliditetit, përjashtimin nga taksat, ofrimin e shërbimeve në mënyrë korrekte, përfitimin e banesave sociale etj.

Përsa i përket sektorit privat, vihet re një rritje e numrit të ankesave për vitin 2012 në këtë sektor dhe përgjithësisht objekt i pretendimit në këto ankesa është diskriminimi në punësim.

3.8 SHPËRNDARJA RAJONALE E ANKESAVE

Qytetet nga të cilat, për vitin 2012, janë paraqitur numri më i madh i ankesave janë Korça, Pogradeci, Saranda, Gjirokastra, Tirana, Shkoder, Lezha, Burreli dhe zonat përreth këtyre qyteteve.

Vlen të theksohet fakti se Komisioneri ka vazhduar edhe për vitin 2012 aktivitetet ndërgjegjësuese në shumë zona të vendit. Kjo ka ndikuar direkt në rritjen e numrit të ankesave me një shpërndarje të gjerë gjeografike.

Ankesa janë paraqitur edhe nga qytetet në të cilat nuk janë zhvilluar akoma takime informuese si Tepelena, Lushnja, Fieri etj, për të cilat Komisioneri ka parashikuar organizimin e ditëve të hapura gjatë vitit 2013.

Për vitin 2013 pritet që numri i ankesave që do të paraqiten pranë Zyrës së Komisionerit do të rritet, falë aktiviteteve ndërgjegjëse dhe informuese që Komisioneri do të zhvillojë në qytete të tjera të vendit.

3.9 Ankesa të cilat nuk janë pranuar për shkak të mungesës së kompetencave

Një pjesë e ankesave të paraqitura në Zyrën e Komisionerit nuk janë pranuar pasi bazuar në ligjin Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shqyrtimi i tyre nuk ka qënë pjesë e kompetencave të tij dhe në këto raste subjektet ankues janë informuar dhe drejtuar në institucionin përkatës. 21 ankesa nuk janë pranuar për këto arsye. Nga këto janë informuar dhe drejtuar në institucionet përkatëse 8 ankesa, kanë qënë të pabazuara 3 ankesa, janë trajtuar më parë nga Komisioneri dhe nuk ka të dhëna të reja 5 ankesa, nuk ka pasur informacionin e duhur për të bërë të mundur një hetim 5 ankesa.



3.10 Rezultatet e procedimeve dhe vendimeve të ankesave

Duke u bazuar në ligjin Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankesat e paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i janë nënshtruar një analize ligjore, nëse ato përmbajnë elemente që një ankesë të pranohet. Nëse ankesa nuk ka pasur elementët e duhur,


KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

nuk ka qënë e plotë ose kishte mungesë të informacionit që mund të pengojë procedurën e mëtejshme të ankesës, i është kërkuar ankuesit që të plotësojë elementët e kërkuar nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ankesës, për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qënë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me njësitë vendore, subjekteve ankues u është ofruar ndihmë nga njësitë vendore në të cilat ata banojnë, duke marrë asistencën e duhur për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2012 ka marrë një numër të konsiderueshëm vendimesh në të cilat ka dhënë rekomandime dhe vendime të cilat, bazuar në ndërmjetësimin e Komisionerit i kanë dhënë zgjidhje ankesës duke arritur qëllimin për të cilin ishte paraqitur ankesa.

Numri i ankesave të cilat janë trajtuar dhe kanë plotësuar kërkesat e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” janë 83. Për 21 prej tyre Komisioneri ka dale me vendime.

Siç shihet dhe nga tabela e mëposhtme për 43.47 % të ankesave të cilat janë nënshtruar procedurave të shqyrtimit të Komisionerit, nuk është konstatuar diskriminim, për 30.45 % të ankesave është konstatuar diskriminim, për 17.41 % të ankesave pavarësisht se nuk është konstatuar diskriminim, janë dhënë rekomandime që synojnë përmirësimin e situatës dhe 8.67 % të ankesave janë zgjidhur me ndërmjetësim.



KAPITULLI IV

NDËRGJËGJESIMI

Në kuadër të realizimit të kompetencave ligjore dhe prioriteteve të Zyrës së Komisionerit, duke patur parasysh nga njëra anë kapacitetet e institucionit të Komisionerit në burime njerëzore dhe financiare, dhe nga ana tjetër bashkëpunimet me institucionet e tjera shtetërore apo mbështetjen nga organizatat ndërkombëtar dhe OJF-të për Zyrën e Komisionerit, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe Zyrën e Komisionerit, janë ndërmarrë një sërë aktivitete në funksion të realizimit të ndërgjegjësimit të komunitetit për çështjet që kasnë të bëjnë me diskriminimin.

4.1 Kontakte të drejtpërdrejta me komunitetin

- **Ditë të Hapura**

Në kuadër të dy projekteve që po implementohen aktualisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të mbështetura nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP) dhe *Zyra e OSBE për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut* ODIHR, janë realizuar Ditë të Hapura në qytete të ndryshme të Shqipërisë.

Konkretisht, në periudhën Shtator - Nëntor 2012 janë zhvilluar Ditë të Hapura me qytetarët e qyteteve: Durrës, Lezhë, Korçë, Sarandë, Përmet dhe Burrel në kuadër të projektit “*Zbatimi i parimit të barazisë gjinore dhe programit të dhunës me bazë gjinore*”, mbështetur nga UNDP.

Ndërkaq, në periudhën Tetor - Dhjetor 2012, u organizuan Ditë të Hapura me qytetarët e qyteteve: Pogradec, Gjirokastrë dhe Komunës Grabian, në kuadër të projektit “*Praktikat më të Mira për Integrimin e Romëve*” (PMIR), mbështetur nga OSBE/ODIHR.

Në këto takime morën pjesë rreth 70-80 qytetarë në secilin qytet nga grupe të ndryshme, duke treguar interesin e lartë për tu njohur me institucionin, funksionimin e tij por edhe për t’iu përgjigjur thirrjes së Komisionerit për të paraqitur problematikat me të cilat hasen qytetarët, nëpërmjet parashtrimit të ankesave për diskriminim.

Për lehtësimin e punës së zyrës së komisionerit në nivel vendor u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi midis Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore përkatëse. (referoju marrëveshjeve të bashkëpunimit në pikën: - Vendojsa e Bashkëpunimit). Gjithashtu, u përcaktuan edhe pikat e kontaktit respektive që do të lehtësojnë më shumë shqyrtimin e ankesave dhe problemeve që ka komuniteti në këto rajone administrative.

Në kuadër të këtij projekti, *Best Practices for Roma Integration*” të OSCE-ODIHR, është përgatitur një spot televiziv për të rritur ndërgjegjësimin e opinionit publik për ligjin dhe kompetencat e Komisionerit. Ky spot ka filluar të transmetohet nga data 11-18 shkurt 2013 në dy televizione kombëtare.

- **Takime të Komisionerit me komunitetin**

Në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë, me datë 26.09.2012, me mbështetjen e UNDP-së, është zhvilluar një aktivitet i përbashkët i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Shoqatës Kombëtare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD) dhe Institutit të Nxënësve që nuk Dëgjojnë, në ambjentet e institucionit të komisionerit. Në takim u prezantuan krijime artistike të realizuara nga nxënësit e këtij Instituti, me asistencën e stafit pedagogjik të Institutit dhe Shoqatës ANAD. Aktiviteti u parapri nga një takim i Drejtoreshës së Përgjithshme të UNDP-së, Znj. Yesim M. Kayame znj. Irma Baraku, Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe znj.Lindita Kalimi, Drejtoreshë e Institutit të Nxënësve që nuk Dëgjojnë. Në takim u evidentuan çështje që shqetësojnë këtë komunitet dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Gjithashtu, Komisioneri ka zhvilluar disa takime në ambjentet e KMD-së me përfaqësues të OJF-ve që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT, rom dhe egjiptian.

4.2 Hartimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuere si broshura, fletëpalosje dhe postera

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konsideruar si pjesë mjaft të rëndësishme në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimin, edhe shpërndarjen e materialeve sensibilizuese si: Broshura Informuese, Fletëpalosje të përgjithshme dhe të veçanta, postera dhe kopje të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Kështu, gjatë vitit 2012 janë shpërndarë 455 Broshura Informuese mbi Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, 260 Fletëpalosje, 526 kopje të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe 200 dosje me logon e Komisionerit.

Gjatë Ditëve të Hapura janë shpërndarë Broshura Informuese mbi ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në gjuhët e pakicave dhe në formate të përshtatshme për personat me aftësi të kuafizuara në shikim (me shkrim Braille).

Në këtë kontekst, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka mbështetur realizimin e “Festivalit të Diversitetit”, që u realizua për herë të parë në vendin tonë, me datë 17 Maj 2012, në kuadër të ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë. Gjatë këtij aktiviteti u shpërndanë edhe Broshura Informuese “*Si e Mbron Komunitetin LGBT Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”?*”, të cilat u hartuan me kontributin e përbashkët të Ambasadës Pink dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

4.3 Organizimi i Konferencave dhe Trajnimeve nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në bashkëpunim me OJF-të

- **Konferenca**

Në organizimin e Konferencave dhe Seminareve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është përpjekur që të tërhiqet vëmendja tek grupet vulnerabël, të cilët janë të margjinalizuara më së tepërmi në shoqëri.

Duke konstatuar se Personat që Nuk Dëgjojnë janë një ndër grupet më pak të artikuluar kur bëhet fjalë për Personat me Aftësi të Kufizuara si dhe duke iu referuar një çështjeje të paraqitur dhe të shqyrtuar ngë KMD në lidhje me këtë target grup, me datë 27.09.2012, në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë organizoi **Konferencën “Edukimi dy-gjuhësor një e drejtë e njeriut, jo një privilegj”**, organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Njerëzve që nuk Dëgjojnë në Shqipëri-ANAD dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Qëllimi i kësaj Konference ishte të diskutohej mbi domosdoshmërinë e gjuhës së shenjave, si dhe të tërhiqte vëmendjen e institucioneve, shoqërisë civile dhe mediave ndaj së drejtës së personave që nuk dëgjojnë, për të marrë në mënyrë të përshtatshme shërbimet në edukim, punësim dhe të mira e shërbime. Komisioneri theksoi garancitë ligjore dhe institucionale për mbrojtjen nga diskriminimi për personat që nuk dëgjojnë. Në përfundim të Konferencës diskutuan anëtarë të organizatës ANAD, ku u shtruan problematikat e hasura prej tyre si dhe u theksua domosdoshmëria e edukimit të personave që nuk dëgjojnë nëpërmjet gjuhës së shenjave.

Duke qënë se Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese edhe në sektorin privat, Komisioneri e konsideroi si prioritet dhe risi tërheqjen e vëmendjes së aktorëve të këtij sektori. Kështu, me datë 22 nëntor 2012, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi **Konferencën Kombëtare “Për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor në sektorin ekonomik”**, me mbështetjen e Agjensisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave UN Women. Në konferencë morën pjesë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të Qeverisë, ekspertë ligjorë, përfaqësues të sindikatave dhe dhomave të tregtisë, akademike dhe studiues, përfaqësues nga Avokati i Popullit në Kosovë, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe medias. Me qëllim nxitjen e bashkëpunimit midis KMD-së dhe aktorëve ekonomikë në vend, gjatë punimeve të kësaj Konference u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimi ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Unionit të Dhomave të Tregëtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka përqëndruar vëmendjen në të drejtat e komunitetit LGBT, duke qënë se promovimi i të drejtave të këtij komuniteti është konsideruar si tabu deri para pak kohësh.

- **Trajnime**

Në kuadër të bashkëpunimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shoqërinë civile si dhe bazuar edhe në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar me Fondacionin

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), një specialist nga Zyra e KMD-së është përfshirë si trainues në projektin “Për promovimin e mundësive të barabarta për punësim përmes legjislacionit nxitës, mekanizmave kundër diskriminimit dhe eksperiencave pozitive”, të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Seminaret janë organizuar në qytetet: Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë. Grupet të cilave u drejtohet ky projekt ishin punonjës të Zyrave Rajonale të Punësimit, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Qëndrave të Formimit Profesional si dhe Departamentit të Administratës Publike, me synimin për t’i ndergjegjësuar dhe trajnuar në lidhje me punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, ofrimin e shanseve dhe mundësive të barabarta si dhe marrjen e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor apo të politikave që synojnë integrimin e këtij grupi vulnerabël drejt tregut të punës, dhe ushtrimit në baza të barabarta të së drejtës për punësim. Në këto aktivitete morën pjesë rreth 97 persona.

Në vijim të bashkëpunimit me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), janë realizuar një cikël seminaresh me temë: “Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara me qëllim zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto seminare, dy punonjës të Komisionerit kanë dhënë kontributin e tyre në kuadër të rritjes së ndergjegjësimin të vetë personave me aftësi të kufizuara mbi ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, me qëllim përdorimin e tij në mënyrë sa më efikente. Qëllimi i këtij seminari, ishte për t’u bërë të njohur personave me aftësi të kufizuara Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, procedurat që ndiqen në rastet e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar por dhe njohja dhe kuptimi i asaj që përbën diskriminim, mënyrat e llojet e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar. Numri i aktiviteteve të organizuara ka qenë gjithsej 7 (shtatë), në 5 rrethe: Tiranë, Korçë, Shkodër, Fier, Vlorë. Numri total i pjesëmarrësve ka qenë 194 persona nga të cilët 136 femra dhe 58 meshkuj. Pjesëmarrësit kanë qenë: personat me aftësi të kufizuara, organizatat që mbrojnë interesat legjitime të tyre si dhe institucione të pushtetit vendor dhe të atij qendror.

Në datat 10 - 11 Shtator 2012, specialist nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në Shkollën Verore PINK, organizuar për herë të parë nga Ambasada PINK/LGBT Pro Shqipëri si një program edukimi dhe ndërtimi dijesh që mbulon fusha të tilla, si: të drejtat e njeriut, dhuna, diskriminimi në bazë gjinore, politikat sociale, çështjet ligjore dhe politike etj. Roli i Komisionerit në këtë shkollë verore ishte trajnimi i anëtarëve dhe aktivistëve pjesëmarrës me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” por dhe zhvillimi i debatit me çështje dhe problematika konkrete që has ky komunitet. Numri i pjesëmarrësve të trajnuar në këtë aktivitet ishte 30 persona.

Në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Shqipëri, të cilët janë një ndër grupet më të marginalizuara, me datë 25 Prill 2012, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u zhvillua një trajnim me anëtarë të shoqatave egjiptiane: “Sfinksi” dhe “Vëllazërimi”. Gjatë këtij aktiviteti, u dha një vështrim i përgjithshëm mbi Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rolin dhe kompetencat e Komisionerit. Gjithashtu u parashtruan, disa nga problematikat e hasura më shpesh në komunitetin egjiptian.

Me qëllim mbrojtjen nga diskriminimi të viktimave të trafikimit, gjatë muajit Prill – Qershor 2012, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është bërë pjesë e projektit me titull: “*Respektimi i të Drejtave të Viktimave të Trafikimit në Shqipëri – Ti Japim Fund Stigmës*”, të Organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”. Ky projekt kishte si qëllim që të ndërmerre një fushatë sensibilizimi në shkallë vendi në kuadër të mos-diskriminimit të viktimave të trafikimit si dhe synonte të përmirësonte të drejtat e viktimave të trafikimit në Shqipëri, duke trajtuar stigmatizimin dhe diskriminimin me të cilin ato përballën gjatë procesit të ri-integrimit në shoqëri. Projekti u shtri në tre qytete: Tiranë, Vlorë dhe Elbasan. Grupet e trajnuara ishin nxënësit e shkollave të mesme publike dhe private, përfaqësues të komuniteteve, dhe punëdhënës. Në vijim të këtij bashkëpunimi, gjatë periudhës Dhjetor 2012 e në vijim të të njëjtit projekt, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi merr pjesë nëpërmjet kontributit të dy punonjësve të Zyrës, për sensibilizimin e target grupeve në dhënien fund të diskriminimit të viktimave të trafikimit si dhe njohjen me detyrimet dhe përgjegjësitë ligjore në kuadër të ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

4.4 Pjesëmarrja në tryeza diskutimi

Qendra e Informimit të BE-së ka organizuar një Tryezë diskutimi me dt. 16.05.2012. Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi mbi ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe problematikat e minoriteteve në Shqipëri. Gjatë këtij takimi u ngiten problematikat e minoriteteve. Gjithashtu, u shtruan dhe pyetje për punën e deritanishme të Komisionerit, hapat e ndërmarra, specifikisht për Komunitetin Rom.

Në kuadër të njohjes dhe implementimit sa më të mirë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në Qershor 2012 një punonës i Komisionerit u bë pjesë e Forumit mbi Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të organizuar nga Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, në qytetin Shkodrës. Në vijim të këtij bashkëpunimi, në Korrik 2012, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut organizoi këtë forum në qytetin e Elbasanit. Gjatë këtyre forumeve u prezantua Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjithashtu, u prezantua aktiviteti i Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut lidhur me fushën e veprimtarisë së këtij Ligji, si dhe nga përfaqësues të pushtetit lokal u fol për rolin e pushtetit lokal në këto qytete, lidhur roli e pushtetit lokal për mbrojtjen nga diskriminimi. Pjesëmarrës në takim ishin kryesisht përfaqësues të pushtetit lokal, media dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Me datë 15 dhe 16 Mars 2012, Komisioneri mori pjesë në Konferencën dy ditore me temë: “*Njëzet Vite Reforma në Sektorin e Sigurisë në Shqipëri: Statusi dhe Sfidat në Qeverisjen Demokratike të Sektorit të Sigurisë dhe Rruga drejt së Ardhmes*”, në lidhje me reformat që janë ndërmarrë këto njëzet vite në Sektorin e Sigurisë. Konferenca kishte për qëllim vazhdimin e reformave në këtë sektor dhe vendosjen e balancave mes legjislacionit/politikave në këtë sektor. Në trajnim morën pjesë përfaqësues të institucioneve që kanë lidhje dhe bashkëpunim me Sektorin e Sigurisë, përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes si dhe ish-ushtarakë, si dhe institucionet e pavarura. Në takim u diskutua rreth ndryshimeve të Sektorit të Sigurisë në këto njëzet vite dhe për reformat e

mëtejshme në këtë sektor. Gjithashtu, u diskutua mbi rolin e institucioneve të pavarura në raport me Sektorin e Sigurisë, rëndësinë e tyre, rritjen e bashkëpunimit, lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit me këtë sektor, si dhe u fol në lidhje me një mbikëqyrje më të fortë nga Institucionet e Pavarura kundrejt Sektorit të Sigurisë.

Pjesëmarrje e Komisionerit në tryezën e rrumbullakët; “Takimi Kombëtar i Shoqërisë Civile në kuadër të Rishikimit të Kodit Zgjedhor në lidhje me Pjesëmarrjen e Grave në Politikë”, me datë 27.01.2012, të organizuar nga Shoqëria Civile (Shoqata Barazi në Vendimmarrje, Albanian Woman Employment Network, Millenium Woman’s Network, Koalicioni për Nxitjen e Pjesëmarrjes së Grave dhe të Rinjve në Politikë. Diskutimi u fokusua në reformën zgjedhore dhe ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor për zbatimin e barazisë gjinore. Temat kryesore të prezantuara ishin: Kuotat gjinore në Kodin Zgjedhor, Kuotat gjinore në Administrimin Zgjedhor, Sanksionet për mosrespektimin e përfaqësimit ligjor, Votimi familjar.

Komisioneri mori pjesë në takimin e organizuar me datë 17.04.2012, nga MPCSSHB me mbështetjen e UNICEF, për lancimin e studimit : “Hartëzimi i shërbimeve për fëmijët romë në Shqipëri”. Pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues të qeverisë shqiptare në nivel qendror dhe lokal, donatorë, përfaqësues të qeverisë civile, komunitetit rom etj. U diskutua për krijimin e një pasqyre të plotë të të dhënave për fëmijët dhe komunitetin rom si një bazë për ngritjen e shërbimeve dhe politikave në të ardhmen, si dhe u bë prezantimi i hartës që përmban të dhënat për komunitetin rom dhe si mund të përdoret kjo hartë për të gjithë politik-bërësit në nivel qendror dhe lokal dhe ofruesit e shërbimeve.

Me datë 07 Qershor 2012, Komisioneri mori pjesë në një tryezë pune, me temë: “Programi Evropian i Trajnimit për Mediatorët Romë” (ROMED), organizuar nga MPCSSHB dhe shoqata “Roma Active Albania” dhe me mbështetjen e KE-së. Pjesëmarrës në takim ishin: përfaqësues nga KE, MPCSSHB, nga qarqet Fier, Berat, Durrës, Korçë, Lezhë, nga Shoqëria Civile si dhe shoqata të ndryshme. U diskutua rreth mundësisë së trajnimit të 20-30 mediatorëve dhe pilotimit të këtij programi në ato Qarqe e Bashki ku numri i banorëve të komunitetit rom është më i madh, ide që u mbështet nga të pranishmit në tryezë. U debatua për kriteret e mediatorëve dhe dobishmërinë e punës së tyre, si urë lidhëse e problemeve të komunitetit rom me institucionet publike.

Me datë 12 Qershor 2012, Komisioneri mori pjesë në aktivitetin me tematikë: “Fëmijëria nuk është shfrytëzim për punë”, mundësuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan, Zyra e Monitorimit dhe Luftës kundër Trafikimit në Njerëz dhe organizuar nga Koalicioni: “Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve”. Paneli, i përbërë nga të rinj e fëmijë, prezantoi problematikat me të cilat përballen bashkëmoshatarët e tyre për shkak të kushteve të ndryshme: ekonomike apo sociale, si dhe u prezantua një spot ndërgjegjësues lidhur me tematikën e trajtuar. Në përmbyllje të takimit u dhanë rekomandime për përmirësimin e situatës.

Me datë 29.06.2012, Komisioneri mori pjesë në publikimin e raportit “Vlerësimi Komunitar për Qeverisjen”, organizuar nga UN Women dhe Bashkia Tiranë. Ky raport ishte një përmbledhje praktike e: metodologjisë që bëri të mundur tërheqjen e mendimeve të komunitetit për qeverisjen lokale, gjë që i mundësoi qytetarëve të shprehin vlerësimin e tyre mbi cilësinë, përshtatshmërinë dhe eficienten e shërbimeve publike, si: shërbimi shëndetësor, arsimit, transporti publik, furnizimi me ujë të pijshëm, mbetjet urbane, mbështetja shoqërore etj. U bë prezantimi i VKQ për qytetin e Tiranës, si dhe i sfidave për implementimin e VKQ-së.

4.5 Pjesëmarrje të Komisionerit në Konferenca dhe Seminare

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku ka shkëmbyer eksperiencat e veta më të mira dhe konkrete të punës së Zyrës së KMD-së, si dhe janë diskutuar problematika të ndryshme të hasura në përditshmërinë e punës së Zyrës. Në këtë kuadër:

Me datë 11 Qershor 2012, në kuadër të Ditës për Informimin e Rinisë, u mbajt Konferenca Kombëtare, organizuar nga OSCE, Vodafone Albania Foundation dhe British Council Albania, ku mori pjesë dhe Komisioneri. Në takim u bë prezantimi i Përfundimeve të Studimit Pilot të financuar nga Prezenca OSCE-së : *“Sfidat me të cilat përballen të rinjtë me aftësi të kufizuara në Shqipëri”*. Komisioneri në fjalën e saj, u ndal në parashikimet ligjore që mbrojnë personat me aftësi të kufizuara nga sjelljet diskriminuese por dhe detyrimin e marrjes së masave pozitive në fushën e arsimit dhe punësimit. Theksoi gjithashtu, se monitorimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve si dhe në fushën e arsimit për PAK dhe propozimi i rekomandimeve është një ndër veprimtaritë e Zyrës, sikundër edhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, për shkak të aftësisë së kufizuar. Në vijim të Konferencës, u prezantua Guida për të Ardhmen: Platforma për Veprim e Forumit për të Rinjtë me Aftësi të Kufizuara.

Në datat 13 – 14 - 15 Qershor 2012, u mbajt Workshop-i me temë: “ Ndal dhunës: Të drejtat e LGBT janë të drejta njerëzore”, organizuar nga Ambasada Amerikane, ku mori pjesë dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këtë takim u përmendën një sërë rastesh ku evidentohen probleme të tilla të dhunës dhe sjelljeve diskriminuese e kërcënuese në drejtim të komunitetit LGBT, të cilat janë hasur në përditshmërinë e punës së Zyrës së Komisionerit. Njëherësh, Komisioneri u ndal dhe në parashikimet ligjore të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminim, në mbështetje të pjesëtarëve të komunitetit LGBT, në rastet kur ata janë diskriminuar, janë bërë pre e dhunës a sjelljeve diskriminuese e kërcënuese, parashikuar në nenin 1 të ligjit “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Komisioneri mori pjesë në “Konferencën Rajonale për të Drejtat e Fëmijëve” me datë 14 Qershor 2012. Në fjalën e saj, Komisioneri u ndal në: parashikimin ligjor për mbrojtjen e fëmijëve nga diskriminimi, njohjen dhe ndërgjegjësimin e Ligjit, në sistemin arsimor dhe përfshirjen në programet mësimore të koncepteve kundër modeleve të sjelljeve diskriminuese e detyrimin e drejtuesve të shkollave për të afishuar Ligjin në ambientet shkollore. U theksua

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

e drejta për arsimim e të gjithë popullsisë, veçanërisht duke marrë masa në favor të pakicave, personave me aftësi të kufizuara si dhe personave që janë ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit; dhe rëndësia e respektimit të e sigurimit të së drejtës për arsimim në gjuhët e pakicave. Në përmbyllje të takimit u nënvizua rëndësia e forcimit të mekanizmave mbrojtës që sigurojnë Mbrojtjen e Fëmijëve.

Seminar 15-16.11.2012 “Grate dhe Korrupsioni ne Shqiperi-Arritjet dhe Prioritetet e se Ardhmes”. Me date 15 Komisioneria foli mbi kontributin e institucionit dhe veprimtarite e KMD ne luften kunder korrupsionit ne shqiperi. Dita e dyte konsultime mbi propozimet e shoqerise civile per hapat dhe masat qe duhet te ndermarrin institucionet shteterore ne kete aspekt.

Në datat 27-29 Qershor, në Budva - Mal të Zi, u mbajt konferenca për lançimin e 3 projekteve rajonale:

- Praktikë më të mira për integrimin e komunitetit Rom
- Promovimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e pakicave në Evropën Jug-Lindore.
- Nisma Rajonale për Arsimin Gjithëpërfshirës

Në këtë konferencë u diskutua për situatën e pakicave / grupeve të cenueshme, veçanërisht e vështirë në Ballkanin Perëndimor, një rajon që ka qenë dëshmitar i konflikteve të armatosura, transformimeve politike dhe tranzicionit ekonomik në njëzet vitet e fundit. Konferenca bëri disa rekomandime për organet monitoruese lidhur me konventat e Këshillit të Europës, siç është konventa për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (FCMN), Karta Europiane për Gjuhën e Minoriteteve (ECRML), Komisioni Europian Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) si dhe Komisionerin e Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut.

Në grupin e punës me temë: “Si të përmirësojmë implementimin e ligjit të Anti-Diskriminimit” mori pjesë si komentatore Komisioneri e Zyrës për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Znj. Irma Baraku. Komisioneri prezantoi disa aspekte pozitive të institucionit si: aktivitete ndërgjegjësuere dhe takime me komunitetin, realizimi i hetimeve ex-officio dhe monitorime të shoqëruara nga rekomandimet për institucionet përkatëse, kryesisht në arsim. Znj. Irma Baraku theksoi rëndësinë e këtyre projekteve rajonale për përmirësimin situatës së diskriminimit të komunitetit rom dhe egjiptian.

Në lidhje me këtë temë u theksua nevoja e fuqizimit të mënyrës së informimit dhe kapaciteteve institucionale në luftën kundër diskriminimit. Nga diskutimet u nënvizuan një sërë masash që duhen ndërmarrë në fusha të ndryshme si: punësim, strehim, edukim e shërbim shëndetësor. Konferenca dëshmoi se Programet Rajonale mbështesin këtë proces përmes promovimit të shkëmbimit të praktikave më të mira, duke ndërmjetësuar aktorë të ndryshëm, duke fuqizuar kapacitetet institucionale dhe të shoqërisë civile në parandalimin e diskriminimit.

Pjesëmarrje të Komisionerit tryezën e rrumbullakët: “Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët e verbër të Shqipërisë”, me datë 28.02.2012, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Implementuar nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë. Në takim u diskutua rreth konkluzioneve të raportit kombëtar vlerësues për situatën arsimore të fëmijëve të verbër në Shqipëri, dhe funksionimin e sistemit kombëtar të mekanizmit të Referimit për identifikimin e

raportimin e fëmijëve të verbër duke përfshirë fëmijët në moshën parashkollore dhe shkollore në institucionet përkatëse të specializuara ose në institucionet e arsimit të rregullt në Shqipëri. Njëherësh, u diskutua për përfshirjen e disa dispozitave të propozuara nga projekti lidhur me funksionimin e sistemit Kombëtar Referues, propozimin e disa Neneve dhe Akteve Nënligjore të amenduara në përputhje me ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Arsimin Special me qëllim institucionalizimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar të Referimit për përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve të verbër në sistemin arsimor të Republikës së Shqipërisë.

Komisioneri dhe një punonjës nga Zyra e Komisionerit referuan në Seminarin me temë: *“Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminim, përpjekje për realizimin e të drejtave dhe barazisë së mundësive për personat me aftësi të kufizuara”*, organizuar me datë 02.05.2012 nga FSHDPAK në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë SOROS. Qëllimi i këtij seminari ishte të bënte prezente gjetjet dhe rekomandimet e Raportit *“Përputhshmëria e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me ligjet bazë të aftësisë së kufizuar”* dhe të Udhëzuesit *“Vështirësi mbi mohimin përshtatjes së arsyeshme, Teoria dhe praktika, si dhe Sfidat e zbatimit në Shqipëri”*.

Në datën 12 Qershor 2012, Komisioneri mori pjesë në tryezën e diskutimit: *“Mjetet e nevojshme ligjore për rritjen e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në vendimmarrje”*, organizuar nga MPCSSHB në bashkëpunim me UNDP. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi legjislacionin shqiptar, lidhur me përputhshmërinë e tyre në këndvështrimin gjinor, me legjislacionin ndërkombëtar. Në takim u prezantuan: Kuadri kushtetues dhe ai ndërkombëtar për përfaqësimin e barabartë gjinor; gjetjet e grupit të punës nga analiza e dispozitave dhe nga problematikat e hasura në praktikë.

Me datë 08.03.2012, Komisioneri mori pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë: *“Të Drejtat e Gruas në Tregun e Punës”*, takim ky i organizuar nga Qendra e Informimit e Bashkimit Evropian, Shkodër; në bashkëpunim me Qendrën Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja e grave me Legjislacionin në fushën e marrëdhënieve të punës, si dhe të drejtat e veçanta të grave gjatë marrëdhënieve në punë. Aktiviteti gjithashtu, synoi të njohë pjesëmarrëset me mënyrat e mbrojtjes së të drejtave të grave në fushën e punës dhe të punësimit dhe sistemin gjyqësor, procedurat e aplikimit për punë, si të përgatiten për një intervistë pune, kanalet e informimit për punësim në BE etj.

Me datën 25 Qershor 2012, Komisioneri mori pjesë në Konferencën *“Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara pjesë integrale e të Drejtave të Njeriut”*, Organizuar nga Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara në bashkëpunim me Avokatin e Popullit. Në fjalën e mbajtur nga Komisioneri, në sesionin e dytë të konferencës, *“Të drejtat e PAK dhe zbatimi i tyre”*, u trajtua tema: *“Diskriminimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, zbatimi i detyrimeve ligjore nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, si dhe roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për monitorimin e zbatimit të tyre dhe reduktimin e diskriminimit.”*Në temë u referuan gjithashtu raste konkrete të hasura në përditshmërinë e punës së Zyrës së KMD-së.

4.6 Leksione të hapura me studentë

Gjatë leksioneve të hapura, Komisioneri referoi në lidhje me situatën aktuale në vend mbi diskriminimin. Në këto aktivitete u shpërndanë edhe materiale ndërgjegjësuese, si broshurë informative mbi ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, fletëpalosje në fushën arsimit si dhe formulari i ankesës.

Me datë 24 Prill 2012, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka zhvilluar një leksion të hapur me studentët e Drejtësisë në Universitetin Evropian të Tiranës ku është folur për

Më datë 9 Maj 2012, ditën e Evropës, u organizua nga i Universiteti “Marin Barleti”, Workshop me temë "Sfidat e Integritit Evropian". Në këtë workshop, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi referoi në lidhje me masat anti-diskriminim.

Gjithashtu, më Maj 2012 Komisioneri ka zhvilluar një leksion të hapur me studentët e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

Në janar 2013, Komisioneri zhvilloi një leksion të hapur “Mbi Rolin e Komisionerit si garant ndaj sjelljeve diskriminuese”, me studentët e nivelit Master Shkencor, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, brenda Modulit “Administrata Publike dhe Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut”

4.7 Roli i medias

Media ka ndikim të jashtëzakonshëm në mënyrën se si publiku formon opinionet dhe këndvështrimet e veta mbi çështje të ndryshme. Ajo ka në mision të saj përcjelljen e informacionit por jo vetëm, ajo është e aftë të përcjell problematika, vlera, modele pozitive, stereotipe etj.

Media konsiderohet një partner i rëndësishëm i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në promovimin e parimit të mos-diskriminimit. Media mund të luajë një rol mjaft të madh në ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut mbi çështjet e diskriminimit dhe dhënien e informacionit të besueshëm për iniciimin e çështjeve për diskriminim. Rrjedhimisht, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i kushton nëmënyrë të përditshmerëndësi të veçantë medias vizive dhe asaj të shkruar duke filtruar çdo çështje që mund të lidhet me objektin e veprimtarisë së KMD-së.

Duke vlerësuar si të domosdoshëm partneritetin me median, me datë 5 tetor 2012, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Znj. Irma Baraku zhvilloi një takim informues me gazetarët me qëllim vendosjen e një komunikimi të vazhdueshëm me median si partnere e rëndësishme në luftën kundër diskriminimit. Ky takim i organizuar nga Komisioneri, u mbështet nga Programi i Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës me Bazë Gjinore të UNDP-së në Shqipëri. Znj Baraku theksoi gjatë këtij takimi në ambientet e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi se “Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi e

konsideron median dhe rolin e saj si të pazëvendësueshëm në përpjekjen tonë të përbashkët për rritjen e ndërgjegjësimit rreth çështjeve të diskriminimit dhe mënyrave për t'i trajtuar e zgjidhur ato". Përfaqësuesit e medias morën informacion të gjerë mbi shkaqet e diskriminimit fushat dhe elementë për të evidentuar dhe raportuar sjelljet diskriminuese.

Një aspekt tjetër tepër i rëndësishëm ka të bëjë me faktin se informacioni i përcjellë nga media ka shërbyer në mjaft raste për të filluar hetime *ex officio*. Nga 14 çështje të iniciuara nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në 12 raste informacioni është marrë nga media.

Një nga kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është t'i drejtohet opinionit publik për çështjet që lidhen me diskriminimin. Në këtë kuadër janë dhënë intervista në rubrika speciale përmes të cilave është informuar publiku për çështjet e diskriminimit dhe Zyrën së Komisionerit. Disa media që kanë transmetuar këto rubrika kanë qenë: Ora News, Chanel One, Vizion+, Scan etj. Gjithashtu, Komisioneri, ka marrë pjesë në debate televizive për çështje specifike të transmetuara në televizione si : News 24, Opinion (Klan), Dritëhije (AS), Debat (TVSH) etj. Deklarata për shtyp për çështje të veçanta synuan ndërgjegjësimin e komunitetit në mënyrë të përgjithshme, por edhe ngritjen e problemeve të një rëndësie të veçantë për grupet më të riskuara nga sjelljet diskriminuese.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë prezent edhe në shtypin e shkruar. Krahasuar me dy vitet e mëparshme është shënuar një rritje e numrit të artikujve. Kjo ndjeshmëri lidhet me aktivitetet me punën e Komisionerit, gjithashtu me ndërgjegjësimin e vetë gazetareve për çështjet e diskriminimi dhe institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Janë rreth 30 artikuj të shkruar të cilat kanë pasqyruar prononcimet dhe veprimtarinë e Komisionerit dhe një sërë artikujsh ku Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bërë publike qendrimet institucionale mbi çështje të rëndësishme sociale nga të cilat do të veçonim: Gazeta Mapo, dt.16.02.2012, "Dënimi për prostitucion diskriminon, ja pse duhet shfuqizuar"; Gazeta Shqiptare, dt.14.12.2012, "Respektimi i të drejtave të Komunitetit LGBT: Arritje dhe Sfidë"; Gazeta Mapo, dt.18.05.2012, " Mes lirisë së shprehjes dhe "gjuhës së urrejtjes".

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të vlerësimit të situatës së diskriminimit ka monitoruar pasqyrimin e çështjeve të diskriminimit gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2012. Ky monitorim është bazuar në analizën sasiore dhe cilësore me këto objektiva kryesore:

- Cilat janë grupet vulnerabël që përcillen nga media e shkruar;
- Fushat ku shfaqet diskriminimi;
- Termat e përdorur në artikujt e shkruar;
- Roli i medias në rritjen e ndërgjegjësimit për format e mbrojtjes nga Diskriminimi.

Mund të konkludojmë se shtypi ka pasqyruar gjerësisht problematikat e atyre grupeve që edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konsideruar si më të riskuara. Vihet re

se gjuha e përdorur në median e shkruar në disa raste nuk ka qenë e përshtatshme dhe disa here ka qenë stigmatizuese. Mungojnë artikuj të cilat përciellin modele pozitive të përpjekjeve integruese të këtyre grupeve vulnerabël në shoqëri. Por, duhet vlerësuar fakti që shtypi i shkruar ka qenë shumë i vëmendshëm ndaj çështjeve të diskriminimit dhe barazisë dhe ndaj respektimit të të drejtave të njeriut dhe përmbushtjes së detyrimeve nga ana e institucioneve përgjegjëse.

KAPITULLI V

REKOMANDIME DHE RAPORTIME TË KOMISIONERIT

5.1 Rekomandime dhe mendime ligjore

Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ushtruar kompetencat ligjore për të dhënë mendime ligjore, përmes:

A- *Pjesëmarrjes në grupet ndërsektorale për hartimin e projekt-ligjeve, Strategjive dhe Planeve të Veprimit. Në këtë aspekt, mund të përmendim:*

Zyra e Komisionerit mori pjesë në Grupin Ndërministror të Punës për projektligjin për Personat me Aftësi të Kufizuar, të organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me mbështetjen e Projektit të UNDP.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qënë pjesë e Grupit të Punës për Hartimin e Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015, duke percjellë sugjerime dhe mendime në lidhje me masat dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren për mbrojtjen nga diskriminimi të fëmijëve. Ky Plan Veprimi u promovua në Prill 2012. Fëmijët nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerësoi se duhen shtuar këto pika: - Masat për të arritur objektivin “Monitorimi i zbatimit të të drejtave të fëmijëve në çdo njësi administrative të qarkut”, u sugjerua që të shtohet si institucion përgjegjës edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në realizimin e monitorimeve për situatën e diskriminimit të fëmijëve në nivel vendor. Veçanërisht bashkëpunimi me Agjensinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve do të konsistojë në shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave mbi situatën e diskriminimit të fëmijëve në Shqipëri, në bazë të monitorimeve që KMD kryen. Gjithashtu, në këtë pikë mund të theksohet edhe mundësia e realizimit të monitorimeve të përbashkëta dhe specifike mes Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; - në lidhje me të drejtën për arsimgjithëpërfshirës dhe cilësor, për fëmijët, u propozua: “Gjithëpërfshirje në mësim nxënie pavarësisht gjëndjes social-ekonomike të familjes, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar apo venddodhjes gjeografike”, u propozua të shtohet Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion përgjegjës për garantimin e mosdiskriminimit në Shqipëri, i cili do të kontribuojë në hartimin dhe dhënien e mendimeve gjatë procesit të hartimit të këtyre teksteve si dhe përshtatjen në gjuhët e minoriteteve dhe etnive.

Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin në hartimin e një Plani Masash për mosdiskriminimin e personave me orientim të ndryshëm seksual, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës: “*Lufta kundër diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor*” të organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në bashkëpunim me Këshillin e Evropës.

Po me datë 19 Qershor 2012, Komisioneri mori pjesë në mbledhjen e radhës së Grupit Ndërmintor të Punës për Ndjekjen e Strategjisë “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom” dhe planit të Veprimit të “Dekadës së Përfshirjes së Romëve”, zhvilluar në mjediset e MPCSSHB-së. Në takim u theksua roli udhëheqës e koordinues i MPCSSHB-së në procesin e krijimit të një sistemi të ri monitorimi dhe raportimi në lidhje me indikatorët e përcaktuar në Planin e Veprimit të “Dekadës së Përfshirjes së Romëve”. Në mbledhje u prezantua realizimi i masave të përcaktuara në planin e veprimit, referuar rekomandimeve në fusha si: arsimit, shëndetësia, strehimi, punësimi, media, antidiskriminimi, regjistrimi civil dhe roli i pushtetit lokal për periudhën Janar – Qershor 2012.

B- Dhënies së Rekomandimeve Legjislative për ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues në fushën e diskriminimit. Në këtë aspekt, mund të përmendim:

Bazuar edhe në Rekomandimet e bëra nga Komiteti CEDAW, pas raportimit të fundit periodik të vitit 2010 të bërë nga shteti shqiptar për ndryshimin e Kodit Penal me qëllim që gratë dhe vajzat që prostitudojnë të mos i nënshtrohen ndjekjes penale dhe dënimit penal, Komisioneri i rekomandoi Kuvendit të R.Sh, që të shfuqizohet neni 113 i këtij Kodi (ushtrimi i prostitucionit). Komisioneri ka konstatuar se kjo dispozitë e Kodit Penal bie në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pasi diskriminon në mënyre të tërthortë gratë për shkak të gjinisë. Rishikimi i nenit 113 është kërkuar me qëllim që viktimat e trafikimit të mos bëhen subjekte të ndjekjes penale dhe ndëshkimit. Në lidhje me këtë nen, ligjvënësi miratoi shtimin e një paragrafi, me këtë përmbajtje “Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”, duke rregulluar një diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj grave.

Komisioneri bazuar edhe në urdhrin e Kryeministrit, nr. 52, datë 23. 04. 2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02, 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka ndjekur mbledhjet e këtij grupi pune. Gjithashtu janë dërguar zyrtarisht rekomandimet për grupin e punës për ato çështje që duhet të përfshihen në këtë akt nënligjor dhe konkretisht është rekomanduar që: - të ndërhyhet në kurrikulat e sistemit arsimor, në mënyrë që të futen në programet arsimore konceptet e diskriminimit, format e shfaqjes së tij si dhe të gjejnë pasqyrim veprimet kundër modeleve të sjelljeve diskriminuese; - të sanksionohet në këtë akt detyrimi i drejtuesve të institucioneve arsimore që të parashikojnë rregulla dhe procedura të qarta për trajtimin e ankesave për diskriminimin që u paraqitën; - të parashikohet detyrimi i drejtuesve të institucioneve publike dhe private për të marrë të gjitha masat e nevojshme që të krijojnë kushtet e përshtatshme dhe mbështetëse efektive në ndihmë të nxënësve me aftësi të kufizuara. - në statistikën zyrtare që mban Ministria e Arsimit dhe Shkencës të përfshijë të dhëna të zbërthyera sipas grupeve të aftësisë së kufizuar, sipas etnive apo shkaqeve të tjera të parashikuara nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” që konsiderohen si grupe që kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit. Mbjajtja e të dhënave të sakta do të shërbejë

për të adresuar marrjen e masave me karakter pozitiv dhe zgjidhjen e problemeve që ndeshën këto kategori - të zyrtarizohet gjuha shqipe e shenjave për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe dëgjim, për të siguruar në këtë mënyrë të drejtën për arsim në mënyrë të përshtatshme. Situata aktuale e kësaj kategorie të aftësisë së kufizuar kërkon një ndërhyrje emergjente, për shkak se mungesa e gjuhës shqipe të shenjave i përjashton këta persona nga pjesëmarrja në të gjitha fushat e jetës.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar zyrtarisht Rekomandime legislative lidhur me Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Kryesisht, Komisioneri ka rekomanduar: - të riformulohet përkufizimi i diskriminimit në përputhje me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” duke shtuar shkaqet të diskriminimit, - të shtohen format e diskriminimit ashtu sic janë parashikuar në Ligj; - harmonizimi i procedurave gjyqësore të parashikuara në Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” me ato të Kodit të Punës; - punëdhënësit të marrin masa për përshtajen e arsyeshme në vendin e punës për Personat me Aftësi të Kufizuara; - Kodi i Punës të parashikojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminim si një nga institucionet kompetente për shqyrtimin e ankesave për shkelje të parimit të barazisë.

Gjithashtu, Komisioneri ka dhënë Rekomandime Legjislative në lidhje me Ligjin nr 69/2012 datë 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Para-Universitar në Republikën e Shqipërisë” të cilat janë marrë parasysh nga grupi i punës për hartimin e këtij ligji, i miratuar në Maj vitin 2012.

C- Dhënies së opinioneve ligjore në Seminare e tryeza diskutimi mbi çështjet që kanë të bëjnë me grupet vulnerabël

Me datë 28.02.2012 është organizuar tryezë e rrumbullakët me temë “Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët e verbër të Shqipërisë”. Gjatë këtij takimi janë diskutuar: konkluzionet e raportit kombëtar vlerësuar për situatën arsimore të fëmijëve të verbër në Shqipëri; Përfshirja e disa dispozitave të propozuara nga projekti lidhur me funksionimin e sistemit Kombëtar Referues, propozimi i disa neneve dhe akteve nënligjore të amenduara në përputhje me ligjin “Për arsimin parauniversitar dhe Arsimin Special”; strategjitë që do të ndërmerren në lidhje me mirëfunksionimin e sistemit kombëtar të mekanizmit të referimit etj.

Me datë 16.05.2012, Komisioneri mori pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë: “Harmonizimi i Legjislacionit në këndvështrimin e Barazisë Gjinore dhe Legjislacioni i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore”, organizuar nga MPCSSHB në bashkëpunim me UN Women dhe UNDP. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi legjislacionin e punës, lidhur me përputhshmëritë e tyre me legjislacionin ndërkombëtar. Njëherësh, u prezantua dhe drafti i rekomandimeve për integrimin e angazhimeve të barazisë gjinore të ligjit “Për sigurimet Shoqërore” dhe ligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, prezantimi i draft-rekomandimeve dhe standardeve ndërkombëtare duke harmonizuar dhe legjislacionin e brendshëm, si dhe i Kodit të Punës kundrejt ligjit për barazinë gjinore në shoqëri.

Me datë 12 Qershor 2012 u orgaznizua një tyezë diskutimi, me temë: “Mjetet e nevojshme ligjore për rritjen e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në vendimmarrje”. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi legjislacionin shqiptar, lidhur me përputhshmërinë e tyre në këndvështrimin gjinor, me legjislacionin ndërkombëtar.

Me datë 19 Qershor 2012 u zhvillua një tryezë teknike diskutimi organizuar nga MPCSSHB me UNDP, “Përmirësime të nevojshme të legjislacionit civil dhe familjar nga këndvështrimi gjinor”. Qëllimi I saj ishte analiza e gjetjeve të grupit të punës nga analiza e dispozitave dhe propozimete për ndryshime në Kodin Civil dhe Kodin Familjar. Kjo tryezë do të shërbejë për Rishikimin e legjislacionit shqiptar nga këndvështrimi i barazisë gjinore.

5.2 Raportime të Komisionerit

Në nenin 26 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcaktohet detyrimi ligjor i Komisionerit për Raportime në Kuvendin e R.Sh ku thuhet shprehimisht se “*Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e komisionerit dhe të zyrës*”. Në hartimin e Raporteve Vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi shërbejnë edhe raportimet 3- mujore të KMD-së pranë Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, në Kuvendin R.SH.

Pas Raportit të Parë Vjetor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për Vitin 2011, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka nxjerrë në korrik të vitit 2012 Rezolutë “*Për vlerësimin e punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi për vitin 2011*”, në të cilën vlerësohet, përgjithësisht, veprimtaria e Komisionerit në lidhje me:

- Fillimet pozitive të veprimtarisë së këtij institucioni në vitin e parë të plotë të veprimtarisë së tij;
- Përpjekjet për vendosjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me organet shtetërore, si dhe me institucionet joqeveritare e organizmat ndërkombëtarë, që kontribuojnë në çështjen e mosdiskriminimit;
- Hartimin dhe miratimin e instrumenteve të rëndësishme strategjike dhe objektivave specifike të domosdoshëm për zbatimin e ligjit dhe monitorimin e tij në vijim;
- Përpjekjet e Komisionerit gjatë ushtrimit të kompetencave për të rritur imazhin e tij profesional dhe për të konsoliduar rolin dhe autoritetin e tij në publik.

Komisioneri ka raportuar veprimtarinë e tij në kuadër të përgatitjes së raporteve vjetore dhe komenteve për zbatimin e Konventave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës ILO, bazuar në observacionin e Komitetit të Ekspertëve për Konventën nr. 111 “Punësim dhe Profesione”. Gjithashtu, Komisioneri ka raportuar në lidhje me raportimin vjetor për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për periudhën Janar - Dhjetor 2012

Për realizimin e Planit të Veprimit për Rekomandimin 11, në kuadër të procesit të integritetit Europian dhe angazhimit të qeverisë shqiptare për realizimin e këtij procesi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë kontributin e tij nëpërmjet raportimeve të mëposhtme,

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

duke bashkërenduar punën edhe me institucione të tjera shtetërore, kryesisht me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si dhe me Ministrinë e Integritit, si koordinatore e procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian:

Në këtë aspekt, Zyra e Komisionerit ka raportuar në strukturat që monitorojnë zbatimin e MSA-së, sic janë: Komiteti i Stabilizim-Asociimit, Nën-komiteti për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë BE - Shqipëri për Marrëveshjen e Stabilizim – Asociimit si dhe Nënkomiteti BE-Shqipëri mbi Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikat Sociale.

Në kuadër të adresimit të 12 Rekomandimeve të identifikuara në Opinionin e Komisionit Europian, Komisioneri ka dhënë kontributin e tij në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit për Plotësimin e 12 Rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Europian për shqipërinë, konkretisht Rekomandimit 11 që i përket të Drejtave të Njeriut, konkretisht *“Të bëhen hapa konkretë në forcimin e mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos të grave, fëmijëve dhe romëve, si dhe në zbatimin e efektshëm të politikave anti-diskriminim.*

KAPITULLI VI

NGRITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KOMISIONERIT

6.1 Seminare, Konferenca dhe Trajnime

Me qëllim ngritjen e kapaciteteve administrative të punonjësve të Zyrës së Komisionerit, janë organizuar këto aktivitete:

Gjatë periudhës Shtator - Nëntor 2012 ka vijuar trainimi i punonjesve te Zyrës së Komisionerit pranë Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (ITAP).

Gjatë muajit Maj është zhvilluar Seminari 3- ditor me qëllim ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së komisionerit, mundësuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP). Në fokus të këtij seminari ishin temat: në diskriminimin për shkak të gjinisë, diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si dhe diskriminimin për shkak të përkatësisë etnike. Gjatë trajnimit u fol rreth diskriminimit për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, koncepte bazë të të drejtave të personave LGBT, u bë prezantimi i Ligjit për Barazinë Gjinore, Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe qasjet e reja të saj, u dhanë përkufizime ligjore mbi diskriminimin e drejtpërdrejtë e të tërthortë seksual, barazinë de facto dhe de jure mes burrave dhe grave, integrimin gjinor, ngacmimin për shkak të gjinisë dhe shqetësimin seksual. U prezantua Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Draft Ligji për Aftësinë e Kufizuar dhe u diskutua rreth monitorimit të zbatimit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Njëkohësisht, vend diskutimi zunë edhe hapësirat sociale dhe institucionale që favorizojnë diskriminimin ndaj romëve/ballkano-egjiptianëve në Shqipëri. Në përmbyllje të takimit, u diskutua se çfarë mund të bëjë Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me iniciativën e vet për të minimizuar diskriminimin në shoqëri, institucione, media ndaj romëve/ ballkano-egjiptianëve.

Pjesëmarrja në trajnimin “Përfshirja e çështjeve LGBT në politikat sociale” e organizuar nga Ambasada PINK, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes Ambasadës Pink dhe institucioneve që kanë rol në drejtim të respektimit të të drejtave të komunitetit LGBT dhe rritjes së kapaciteteve në këtë drejtim, ku natyrisht Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka një rol mjaft të rëndësishëm në këtë aspekt.

Me datën 18.04.2012, Komisioneri mori pjesë në trajnimin me temë: “Eliminimi i diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor”, organizuar nga Ambasada PINK në bashkëpunim me MPCSSHB. Trajnimi kishte si qëllim rritjen e kapaciteteve të pjesëmarrësve lidhur me çështjet LGBT dhe mënyrat e përfshirjes së këtyre

çështjeve në punën e tyre, si dhe rritja e bashkëpunimit mes Ambasadës PINK dhe institucioneve që kanë rol në drejtim të respektimit të të drejtave të komunitetit LGBT. U diskutua për të drejtat e LGBT në kuadër të të drejtave të njeriut: të drejtat, diversiteti, toleranca, konteksti historik, dimensionimi i të drejtave (media, shoqatat, procesi i nevojshëm, shëndeti), dokumentet përkatëse të UN dhe EU, ligjet, politikat.

Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga MPCSSHB me mbështetjen e Projektit të UNDP-së *“Promovimi i të Drejtave të Aftësisë së Kufizuar në Shqipëri, Program Mbështetës për Konventën për të Drejtat e Personave më Aftësi të Kufizuara”*, për strukturat që në bazë të Konventës për të Drejtat e Personave më Aftësi të Kufizuara iu besohet monitorimi i zbatimit të saj.

Me 21 Qershor 2012, përfaqesues të Zyrës së Komisionerit morën pjesë në takim me temë: *“Mbrojtja e Privatësisë dhe e drejta për akses në dokumentat zyrtarë”*. Qëllimi i këtij takimi ishte të bëhej i njohur legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, aksesin në informacionin zyrtar. (AIZ). Në takim referuan Z. Igli Pira, drejtor i marrëdhënieve me publikun të KMDP-ja, Z. Graham Sutton, ish-zyrtar i qeverisë britanike, përgjegjës për Politikën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Znj. Dorota Skolimoëska, drejtuese e projektit IPA për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ligji për të drejtën e informimit u trajtua në kontekstin e legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar. Pjesë e takimit ishin: përfaqesues nga institucionet e ndryshme shtetërore si: ministritë e ndryshme, Prokuroria, Kryeministria dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

-Me datën 06.04.2012, përfaqesues të Zyrës së Komisionerit morën pjesë në Konferencën Kombëtare me temë: *“Integrimi i minoritetit Rom në shoqërinë shqiptare dhe ruajtja e identitetit të tij kulturor”*. Në takim u theksua rëndësia e fuqizimit të komunitetit rom, drejt integrimit të tij në shoqërinë mazhoritare, roli dhe bashkëpunimi i MASH për përmirësimin e situatës arsimore të minoritetit rom në Shqipëri, roli e bashkëpunimi i MPCSSHB për integrimin social të këtij komuniteti, roli e bashkëpunimi i MTKRS për promovimin e kulturës rome, si një mënyrë për ruajtjen dhe transmetimin e identitetit kulturor të këtij minoriteti.

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, me datë 18 Maj 2012, organizoi tryezen e rrumbullaket me temë: *“Pabarazia Gjinore në pagë – Një rast shqiptar”*, takim ku morën pjesë përfaqesues të Zyrës së Komisionerit dhe përfaqësues nga MPCSSHB, Fondacioni SOROS, Instituti Agenda, ekspertë të ndryshëm ligjorë etj. Në takim u diskutua rreth tematikave, si: diferenca gjinore në pagë, një rast studimi në zonën urbane të Shqipërisë, parimet e barazisë gjinore në çështjen e pagës në legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar, si dhe gratë shqiptare dhe punësimi (varfëria).

Me datë 02.05.2012, përfaqesues të Zyrës së Komisionerit morën pjesë në tryezën e rrumbullakët, me temë: *“Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të mekanizmit të barazisë gjinore në nivel qendror dhe vendor në Shqipëri”*, organizuar nga OSCE. Pjesë e takimit ishin edhe : Kreu i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, përfaqësues nga MPCSSHB, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes etj. Në takim u bë prezantimi i raportit të vlerësimit të

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

mbështetur nga OSBE “Nëpunësit gjinorë në nivel qendror dhe vendor në Shqipëri”, si dhe prezantimi i rasteve të përzgjedhura.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit do të përfshihet në programet e trajnimit të Shkollës së Magjistraturës, me temë “Aftësimi në zbatimin e legjislacionit për barazinë gjinore”.

KAPITULLI VII

BASHKËPUNIMI ME AKTORËT E TJERË

7.1 Bashkëpunimin Institucional

Në kuadrin e vendosjes se bashkëpunimit institucional, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nënshkruar Marrëveshjet Bashkëpunimi me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe me aktorë të sektorit privat. Gjatë vitit 2012, janë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe:

1. Ministrisë së Drejtësisë
2. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
3. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit
4. Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve
5. Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
6. Fondit Shqiptar të Zhvillimit
7. Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Ndërkaq, një vëmendje të vecantë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka kushtuar edhe bashkëpunimit me institucionet shtetërore në nivel vendor. Kështu, gjatë Ditëve të Hapura, që KMD ka realizuar në kuadër të dy projekteve të rëndësishme që ende po aplikohen me mbështetjen financiare të ODOHR dhe UNDP³⁰, janë nënshkruar deri tani 11 Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe:

1. Bashkisë Elbasan;
2. Bashkisë Gjirokastrë;
3. Bashkisë Durrës;
4. Bashkisë Burrel;
5. Bashkisë Pogradec;
6. Bashkisë Lezhë;
7. Bashkisë Korçë;
8. Bashkisë Përmet;
9. Bashkisë Sarandë;
10. Komunës Grabian

Një aspekt tjetër i rëndësishëm gjatë nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit është caktimi i një pike kontakti respektive që do të lehtësojë nga njëra anë, bashkëpunimin mes KMD-së dhe pushtetit vendor dhe nga ana tjetër, do të lehtësojë procedurën e shqyrtimit të ankesave dhe problemeve që komuniteti ka në këto njësi administrative.

7.2 Bashkëpunimi me organizatat jo-fitimprurëse

³⁰Shih piken 7.3: Bashkëpunimi me organizatat nderkombetare

Bashkëpunimi me shoqërinë civile konsiderohet si një aspekt mjaft i rëndësishëm për KMD-në, në kuadër të ndërgjegjësimit të komunitetit por edhe grupeve të veçanta mbi ligjin “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”. Bashkëpunimi konsiston në realizimin e projekteve ku përfaqësues të Zyrës së Komisionerit kanë dhënë kontributin në lidhje me ndërgjegjësimin e komunitetit mbi ligjin dhe rolin e KMD-së në këtë fushë, duke nxitur njëkohësisht që këto grupe të trajnuara (si institucione shtetërore dhe komunitete të vecanta) të sjellin sa më shumë raste diskriminimi.

Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka krijuar tashmë një adresar të organizatave jo-fitimprurëse me rreth 80 Organizat Jo-Fitimprurëse që veprojnë në rang kombëtar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Bashkëpunimi me këto OJF është i vazhdueshëm dhe ka konsistuar kryesisht në organizimin dhe pjesëmarrjen e aktiviteteve të përbashkëta, si trajnime, tryeza diskutimi, konferenca, seminare etj. Hartimi i Planit Strategjik 2012-2015 dhe Planit të Veprimit për vitin 2012 për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kaluar nëpërmjet një procesi të gjatë konsultimi me të gjithë aktorët e shoqërisë civile, të cilët, me veprimtarinë e tyre, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në mbrojtjen e çdo personi nga sjelljet diskriminuese apo që i nxitin ato.

Gjatë vitit 2012, me qëllim mbrojtjen nga diskriminimi të viktimave të trafikimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është bërë pjesë e projektit me titull: “*Respektimi i të Drejtave të Viktimave të Trafikimit në Shqipëri – Ti Japim Fund Stigmës*”, të Organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”. Ky projekt kishte si qëllim që të ndërmerre një fushatë sensibilizimi në shkallë vendi në kuadër të mos-diskriminimit të viktimave të trafikimit si dhe synonte të përmirësonte të drejtat e viktimave të trafikimit në Shqipëri, duke trajtuar stigmatizimin dhe diskriminimi me të cilin ato përballën gjatë procesit të ri-integrimit në shoqëri.

Në kuadër të bashkëpunimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shoqërinë civile si dhe bazuar edhe në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHHPAK), një specialist nga Zyra e KMD-së është përfshirë si trainues në projektin “*Për promovimin e mundësive të barabarta për punësim përmes legjislacionit nxitës, mekanizmave kundër diskriminimit dhe eksperiencave pozitive*”, të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në vijim të bashkëpunimit me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHHPAK), janë realizuar një cikël seminaresh me temë: “*Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara me qëllim zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Në këto seminare, dy punonjës të Komisionerit kanë dhënë kontributin e tyre në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit së vetë personave me aftësi të kufizuara mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, me qëllim përdorimin e tij në mënyrë sa më eficiente.

Gjithashtu, Komisioneri ka bashkëpunuar me organizata të tjera si: Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale ALTRI – në kuadër të projektit “Mbrojtja nga Diskriminimi: Njih të Drejtat dhe Detyrimet e tua” etj.

Në kuadrin e vendosjes së bashkëpunimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nënshkruar Marrëveshjet Bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile. Gjatë vitit 2012, janë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe:

8. Fondacionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Shqipëri (ADRF Albania)
9. Shoqatës së Artistëve të Rinj të Skenës

7.3 Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare

Aktualisht, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po zbaton 2 projekte të rëndësishme.

- I. Projekti i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i mundësuar financiarisht nga PNUD, me temë:

“ZBATIMI I PARIMIT TË BARAZISË GJINORE DHE PROGRAMIT TË DHUNËS ME BAZË GJINORE”

Qëllimi i këtij projekti është “Rritja e efektivitetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në trajtimin e çështjeve të diskriminimit me bazë gjinore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve profesionale të stafit të tij dhe ngritja e ndërgjegjësimit të komunitetit”.

Afati i projektit: Shtator 2012 – Shtator 2013

Objektivat e projektit janë:

Objektivi I: Fuqizimi i kapaciteteve teknike të stafit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, veçanërisht për çështje që lidhen me barazinë gjinore.

Aktivitetet që do ndërmerren në kuadër të këtij objektivi janë:

- Vizita studimore të stafit profesional të Zyrës së Komisionerit në zyrat homologe, të planifikuara për t’u realizuar me qëllim njohjen dhe marrjen e praktikave më të mira për adresimin e çështjeve të diskriminimit.
- Jurisprudencë e përkthyer në shqip të vendimeve historike të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës Europiane të Drejtësisë, Komitetit CEDAW dhe institucioneve të

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

barazisë, veçanërisht nga Shtetet e Europës Perëndimore, mbi çështjet e barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit, të cilat synojnë që ti shërbejnë si referencë stafit të KMD-së për zgjidhjen e çështjeve.

- Me qëllim rritjen e profesionalizmit të stafit të KMD-së, do të krijohet dhe mbështetet një grup me ekspertë të jashtëm të fushës së diskriminimit. Roli i këtij grupi do të konsistojë në analizimin dhe këshillimin mbi çështje dhe vendime të Komisionerit që i përkasin fushës së diskriminimit, për shkaqe të ndryshme. Anëtarët e këtij grupi këshillimi do të kenë njohuri të mira për të ofruar ekspertizë mbi çështjet e diskriminimit.

Objektivi II: Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Aktivitetet që do ndërmerren në kuadër të këtij objektivi janë 10 Ditë të Hapura në: Tiranë, Durrës, Fier, Skrapar, Përmet, Sarandë, Tropojë, Lezhë, Burrel, Shkodër.

Organizimi i këtyre takimeve synon që të informojnë dhe të ndërgjegjësojë popullsinë mbi rolin e KMD-së si dhe të rrisë numrin e ankesave që do të paraqiten në Zyrën Komisionerit apo në Gjykatë. Në këto Ditë të Hapura do të formalizohen edhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Kryetarët e Bashkive respektive.

Media do të përdoret si një mjet për informimin e publikut mbi legjislacionin anti-diskriminim dhe t'i inkurajojë ata që përdorë shëbimet e Komisionerit Anti-Diskriminim. Trajnimi i gazetarëve për raportimin e çështjeve të diskriminimit është një tjetër aktivitet.

Programe dhe artikuj të ndryshëm do të përgatiten me qëllim që t'i shpjegohet publikut procesi i ankimit.

- II.** Projekti i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i mundësuar financiarisht **ODIHR**, si implementues i këtij projekti rajonal (EU) – OSCE – ODIHR, me temë:

“PRAKTIKAT MË TË MIRA PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETIT ROM”

Afati i projektit: Korrik 2012 – Shkurt 2013

Objektivat e projektit janë:

1. Forcimi i kapaciteteve të aktoreve shtetërore duke përfshirë Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi dhe Njesitë e Qeverisjes Vendore për sigurimin e barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi
2. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian mbi Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi
3. Krijimi dhe forcimi i lidhjeve midis Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe njësive të qeverisjes lokale për të siguruar mbrojtje efektive nga

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Kjo lidhje dhe bashkëpunim fillon me caktimin e një personi si pikë kontakti në strukturën e bashkisë/komunës dhe me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit, të nënshkruar mes KMD dhe njësive të qeverisjes vendore përkatëse;

4. Mbështetje për organizimin e Ditëve të Hapura në Zyrat e qeverisjes lokale, nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të shpjeguar banorëve lokal, duke përfshirë romët dhe egjiptianët, mënyrën se si mund të ankohen tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Aktivitetet që do ndërmerren në kuadër të këtij objekti janë:

- Prodhimi dhe shfaqja e një Spoti televiziv me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë mbi ligjin dhe kompetencat e KMD
- Organizimi i Ditëve të Hapura në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore në 7 bashki dhe komuna: Bashkia Lezhë, Komuna Sushice, Bashkia Lushnjë, Komuna Grabian, Bashkia Pogradec, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Tiranë.
- Gjatë zhvillimit të këtyre Ditëve të Hapura, Komisioneri do të nënshkruajë Marrëveshje Bashkëpunimi me Kryetarët e Bashkive apo komunave respektive. Gjithashtu, do të vendoset një pikë kontakti, nga stafi i KMD-së, në mënyrë që të referohen raste tek zyra e Komisionerit dhe të organizohen Ditë të Hapura në mënyrë periodike.
- Fushatë ndërgjegjësimi 2-ditore.

• **Situata aktuale për mbështetjen IPA**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2013 e në vazhdim do përfitojë nga Programi Kombëtar IPA 13 në sektorin e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme në të cilën një nga masat që propozohet të përmirësohet nga Qeveria e Shqipërisë është dhe përmirësimi i politikave antidiskriminim në Shqipëri.

KAPITULLI VIII

ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

8.1 Menaxhimi i burimeve njerëzore

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse gjatë vitit 2012 ka pasur në qendër të vëmendjes menaxhimin me efikasitet të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike, të vëna në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Struktura dhe organika e institucionit të Komisionerit është miratuar me vendimin nr. 34, datë 20.05.2010 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Struktura e Zyrës së Komisionerit sipas këtij vendimi paraqitet si më poshtë:



Gjatë vitit 2012, janë ndjekur në vijimësi procedurat që parashikon Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, për rekrutimin e punonjësve të Zyrës.

8.2 Menaxhimi i burimeve financiare


Në bazë të nenit 21/4 të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri ka buxhetin e vet të pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga donacione të ndryshme.

8.2.1 Realizimi i Buxhetit të Shtetit për vitin 2012

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Për vitin 2012, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond i planifikuar, në fillim të vitit, **prej 43.606 në mijë lekë**, vlerë e cila me buxhetin e rishikuar është **39.106 në mijë lekë**. Në zbatimin e këtij buxheti, KMD është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Grafiku i mëposhtëm paraqet zhvillimet në vite në buxhetin e KMD.



- Detajimi i Buxhetit Për Vitin 2012**

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar buxhetin e Komisionerit dhe përdorimin e tij për vitin 2012.

Emërtimi	Plan	Rishikuar	Fakt	Diferenca	Vlerat në %
Paga dhe Sigurime Shoqërore	25106	20606	20598,66	7,3	100
Mallra dhe Shërbime të tjera	7000	7000	6999,10	0,9	100
Investime	11500	11500	9967.69	1532,31	87
Totali	43606	39106	37565,48	1540,52	96

Gjatë vitit 2012 një nga detyrat parësore dhe prioritare ka qënë ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi me qëllim mundësimin e zhvillimit të një aktiviteti normal të punës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës, plotësimin e nevojave të punonjësve me paisje. Në këtë drejtim, KMD ka realizuar shtatë procedura prokurimi, si më poshtë:

- Rikonstruksionin e Zyrave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (diferencë nga prokurimi në 2011)

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

- Blerje pajisje dhe orendi zyre
- Blerje pajisje kompjuterike (informatike)
- Instalim sistem aksesi
- Paisje zjarri
- Tabele identifikuese KMD
- Piktura për Zyrën KMD

8.2.2 Detajimi i Buxhetit të Donatorëve për Vitin 2012

Gjatë vitit 2012, buxheti i Komisionerit është financuar edhe nga donacione të ndryshme. Siç mund të konstatohet nga tabela e mëposhtme, buxheti i donatorëve është realizuar në masën 64 % gjatë vitit 2012 dhe pjesa e mbetur do të përdoret për realizimin e projekteve në vazhdim gjatë vitit 2013.

Tabela e mëposhtme paraqet detajimin e buxhetit të donatorëve

Donator		Plan	Shpenzuar	Tepricë	Realizimi në %
UNDP	Përshtatja e institucionit	1.000.990	1000986	4	100
UNICEF	Projekt Trajnim + Monitorim	719.400	623400	96.000	87
UNDP	Sensibilizim	940.000	68500	871.500	7
TOTALI		2.660.390	1.692.886	967.504	64

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka patur bashkëpunim edhe me donatorë të tjerë si OSBE, SOROS etj, për realizimin e aktiviteteve të KMD-së kryesisht në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit dhe ngritjes së kapaciteteve administrative të institucionit. Në këto donacione, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qënë përfitues, pasi buxheti i këtyre projekteve është menaxhuar nga vetë këto organizata.

Për vitet e ardhshme, është hartuar Projekt Buxheti Afatmesëm 2013 -2015 në përputhje me objektivat e punës të vendosura për këto vite.

Për vitin 2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të zbatojë me korrektësi treguesit e buxhetit të planifikuar për institucionin, duke synuar maksimizimin e efektivitetit

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

të shpenzimeve, në funksion të përmbushjes së kompetencave të parashikuara në ligjin 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë e tij Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Bazuar në situatën e e konstatuar mbi zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë të paraqitur në këtë raport si dhe duke u bazuar njëkohësisht në veprimtarinë dhe ankesat e trajtuara nga institucioni gjatë vitit 2012, janë evidentuar disa çështje dhe problematika kryesore që kanë nevojë të adresohen në mënyrë që të garandohet respektimi i parimit të barazisë. Konkretisht kërkohet nga të gjithë institucionet dhe autoritetet përgjegjëse :

1. Në mënyrë që të sigurohet një monitorim më i mirë i situatës së diskriminimit kërkohet krijimi i një sistemi të centralizuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për çështjet e diskriminimit. Ky sistem duhet të gjenerojë të dhëna mbi shkaqet e diskriminimit, format e shfaqjes së diskriminimit, fushën e diskriminimit, të dhëna mbi viktimat e diskriminimit dhe autorët e konsumimit të sjelljeve diskriminuese. Duhet që sistemi të prodhojë të dhëna mbi ecurinë gjyqësore të çështjes, duke përfshirë këtu jo vetëm shqyrtimin civil të çështjeve të diskriminimit, por edhe procedimet penal.
2. Ekzistojnë një sërë aktesh ligjore dhe politika që janë në veprim dhe që kanë parashikime dhe masa për mbrojtjen nga diskriminimi. Krijimi i një dokumenti strategjik kombëtar për luftën kundër diskriminimit do të koordinonte më mirë të gjitha masat në fuqi dhe veprimet e autoriteteve përgjegjëse sipas fushave të tyre të kompetencës, do të garantonte një zbatim më efektiv të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi duke ofruar kështu mbrojtje më efektive nga diskriminimi.
3. Janë miratuar dokumenta strategjikë kombëtarë që parashikojnë marrjen e masave për të përmirësuar kushtet e disa grupeve vulnerabël të shoqërisë siç janë; romët, personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët, personat në kushtë jo të mira ekonomike, personat LGBT, e për të garantuar që këta persona të gëzojnë në mënyrë të barabartë dhe pa u diskriminuar me të tjerët të drejtat dhe liritë që u garantohen. Suksesi i zbatimit të këtyre masave në pjesën më të madhe varen dhe janë përgjegjësi e pushtetit vendor. Pushteti vendor ofron pjesën më të madhe të shërbimeve. Për këtë arsye është thelbësore jo vetëm një bashkëpunim më i mirë dhe i koordinuar midis pushtetit qëndror dhe atij vendor, por kërkohet nga ky i fundit që të marrë masa për zbatimin e parashikimeve që janë bërë për këto grupe të marginalizuara.
4. Gjatë procesit të hartimit të akteve ligjore apo nënligjore, akteve/masave të tjera që marrin organet e administratës publike, organet e qeverisjes vendore apo çdo lloj autoriteti publik, duhet që të mbahet gjithmonë parasysh dhe paraprakisht të bëhen analiza të posaçme për efektet sociale që mund të sjellin këto akte për grupe të veçanta që janë vulnerabël, për të shmangur prashikime që mund të gjenerojnë situata diskriminuese.
5. Duhet që në çdo rast të nxitet përfshirja e grupeve vulnerabël në të gjitha fushat dhe veçanërisht kërkohet nga autoritetet publike që në çdo rast të përfshijnë dhe konsultojnë këto grupe kur ato trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me interesat e tyre.

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

6. Për të garantuar aksesin në drejtësi të viktimave të diskriminimit që përgjithësisht nuk janë në pozita për të përballuar kostot financiare, apo që për shkakë të tjera nuk mund të përmbushin kriteret e caktuara për të përfituar nga ndihma ligjore falas, është e domosdoshme që të rishikohen kriteret për të përfituar ndihmë ligjore falas dhe të shikohet mundësia për reduktimin e kostove për të aksesuar sistemin gjyqësor.
7. Kërkohej që perspektivat e parashikuara në dokumentat strategjike kombëtare apo lokale dhe planet e tyre të veprimit për grupe vulnerabël si gratë, fëmijët, personat lgbt, rom, personave me aftësi të kufizuara etj, të integrohet në të gjitha vendimarrjet dhe politikat e autoriteteve publike. Kjo duhet të shoqërohet në mënyrë të domosdoshme me parashikime/linja të posaçme buxhetore.
8. Media jap një kontribut të madh në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, ndryshime sociale dhe të kulturës së njerëzve, duke luftuar në këtë mënyrë stereotipet dhe paragjykimet që mund të ekzistojnë ndaj minoriteteve apo grupeve të caktuara sociale të marginalizuara. Është e domosdoshme të nxitet media për të rritur ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen nga diskriminimi. Media duhet të jetë më e hapur për të pasqyruar me objektivitet çështjet e diskriminimit dhe problematika të grupeve vulnerabël. Media përveç problematikave duhet të promovojë modele pozitive, suksesi dhe tolerance.
9. Kërkohej që sa më shpejt të ndërhyhet në kurrikulat e sistemit arsimor, tekstet shkollore, në mënyrë që të përfshihen në programet arsimore konceptet e diskriminimit, format e shfaqjes së tij, veprimet kundër modeleve të sjelljeve diskriminuese. Kjo shërben për të rritur ndërgjegjësimin, respektin për diversitetin, tolerancën dhe për të luftuar stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimin.
10. Duhet marrë masa për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të drejtuesve të institucioneve arsimore, mësuesve, nxënësve, por edhe prindërve, për të rritur ndërgjegjësimin kundër sjelljet diskriminuese.
11. Duhet marrë masa për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të drejtuesve të institucioneve arsimore, mësuesve dhe nxënësve, për të forcuar kapacitetet e tyre për identifikimin e diskriminimit në shkolla dhe trajtimin efektiv të rasteve dhe ankesave për diskriminim.
12. Duhet nxitur dialogu social në ambientet universitare për të diskutuar dhe trajtuar problematika dhe çështje të lidhura me diskriminimin dhe luftën kundër tij.
13. Duhet marrë masa për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të administratës publike dhe punonjësve të sektorit privat, për të rritur ndërgjegjësimin dhe kapacitetet e tyre për të krijuar mekanizma për promovimin e ofrimit të shanseve të barabarta në punësim dhe ofrimin e shërbimeve.
14. Duhet të merren masa për të garantuar zbatimin efektiv të legjisllacionit të ri të miratuar në fushën e arsimit, legjisllacionit në fushën e punësimin dhe formimit profesional, duke eliminuar barrierat në ndërtesa, transport, informacion, komunikim, si dhe në çdo

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

aspekt tjetër të shërbimeve që janë publike, për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë në baza të barabarta me të tjerët dhe pa u diskriminuar të drejtat dhe liritë që garantohen.

15. Duhet bërë ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë për të garantuar që të kriminalizohen si krime të urrejtjes, edhe aktet që bërë thirrje për urrejtje kundër personave për shkaqet e parashikuara dhe që mbrohen nga ligji nr. 10 221 datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.
16. Duhet trajnime të vazhdueshme për punonjësit e policisë dhe prokurorët për të rritur kapacitetet e tyre për të identifikuar, reaguar dhe hetuar në mënyrë efektive krimet e urrejtjes duke bashkëpunuar ngushtësisht me aktorët social.
17. Duhet trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët, prokurorët, avokatët, qofshin këta të fushës civile apo penale, për të siguruar një zbatim efektiv të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi, për të garantuar një interpretim uniform nga ana e gjyqësorit të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe në përputhje me standartet europiane dhe ndërkombëtare. Në këtë mënyrë do të garantohet një mbrojtje më e mirë për viktimat e diskriminimit.
18. Duhet që institucionet publike të zhvillojnë mekanizma për të mbështetur në K.M.D-në, në kohë dhe me të gjithë informacionin e kërkuar për shqyrtimin e çështjeve të diskriminimit.